



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.23

23 mars

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.110, datë 26.1.2011	Për miratimin e protokollit të mirëkuptimit dhe të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), i përbërë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe shoqërisë “La Petrolifera Italo-Albanese” sh.a., “PIA”	823
Vendim i KM nr.111, datë 26.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit”, të ndryshuar.....	829
Vendim i KM nr.112, datë 17.2.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.411, datë 29.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Korçë dhe Durrës”, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.448, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”	830
Vendim i KM nr.113, datë 17.2.2011	Për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS-it dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit.....	830

Vendim i KM nr.114, datë 2.2.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar.....	837
Vendim i KM nr.115, datë 17.2.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lekaj të qarkut të Tiranës.....	837
Vendim i KM nr.116, datë 17.2.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	838
Vendim i KM nr.119, datë 17.2.2011	Për dhënie ndihme financiare fondacionit “Refugees International”, në kujtim të veprës së diplomatit të shquar amerikan Richard Holbrooke.....	839
Vendim i KM nr.121, datë 17.2.2011	Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki.....	839
Vendim i KM nr.122, datë 17.2.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”.....	847
Vendim i KM nr.137, datë 1.3.2011	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Gosë, z. Sinan Shala.....	848
Vendim i KM nr.138, datë 1.3.2011	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dajt, z. Kujtim Qefalia.....	848
Vendim i KM nr.187, datë 9.3.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1078, datë 29.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për autorizimin e importit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, për qëllime riciklimi, nga shoqëria Kurum International sh.a.”	848
Udhëzim i MPPT dhe MF nr.6, datë 17.2.2011	Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar.....	849
Vendim i ERE nr.14, datë 28.2.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HP Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	851

Vendim i ERE nr.15, datë 28.2.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “HP Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	852
Vendim i ERE nr.16, datë 28.2.2011	Për mbylljen e procedimit administrativ për shoqërinë “Balkan Finance Investment Group” sh.p.k., lidhur me kërkesën për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	853
Vendim i KNSH nr.35, datë 1.2.2011	Për revokimin e vendimit nr.33, datë 15.2.2010 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”.....	853
Vendim i KNSH nr.36, datë 1.2.2011	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” sh.a., për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”	854
Vendim i KNSH nr.37, datë 1.2.2011	Për miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në sektorin postar”.....	856
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Haki Sula.....	859
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Paqësor Ismailaj.....	859
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Evangjellos Bineri.....	859

VENDIM
Nr.110, datë 26.1.2011

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË MIRËKUPTIMIT DHE TË MARRËVESHJES SË LIDHUR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR (OSHA), I PËRBËRË NGA MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, MINISTRI I FINANCAVE DHE MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, DHE SHOQËRISË “LA PETROLIFERA ITALO-ALBANESE” SHA, “PIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9231, datë 13.5.2004 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës”, si dhe për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës” dhe të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të mirëkuptimit dhe të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), i përbërë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Financave dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe shoqërisë “La Petrolifera Italo-Albanese” sh.a., “PIA”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL MIRËKUPTIMI DHE MARRËVESHJE

Me anë të kësaj Marrëveshjeje të lidhur më 12 janar 2011 nga dhe ndërmjet:

Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (në vijim referuar si “OSHA”), i përbërë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Financës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e autorizuar rregullisht nga ligji nr.9231, datë 13.5.2004 (në vijim referuar, gjithashtu, edhe si “Qeveria”), dhe “La Petrolifera Italo Rumena” S.p.A., shoqëri e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Italisë, me seli të regjistruar në Milano, *via del Bollo 4*, dhe seli administrative në Bolonja, *viale Aldini 190*, përfaqësuar nga drejtori administrativ, dr. Guido Ottolenghi, i autorizuar rregullisht (në vijim referuar si “PIR”) dhe “La Petrolifera Italo Albanese” sh.a., shoqëri e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve shqiptare, me seli në Tiranë, rruga “Ismail Qemali”, P. 34/1, kati 3, ap. 3/4, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, dr. Guido Ottolenghi, i autorizuar rregullisht (në vijim referuar si “PIA” ose “Koncesionari”, sipas rastit).

(Qeveria, PIR dhe PIA referohen së bashku si “Palët” ose veçmas si “Pala”), meqenëse:

A) Palët kanë lidhur marrëveshjen e koncesionit për terminalin BOO dhe marrëveshjen e koncesionit portual BOT (në vijim, së bashku do të referohen si “Marrëveshjet e koncesionit”,

veçmas si “Marrëveshja BOO” dhe “Marrëveshja BOT”) më 24 maj 2004. Kuvendi i miratoi dhe ratifikoi marrëveshjet e koncesionit, të cilat hynë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.9231, datë 13 maj 2004, të shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr.4250 të 16 qershorit 2004, dhe më pas i zgjidhën mosmarrëveshjet e tyre të vitit 2006 me anë të marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim të nënshkruar nga palët më 10 maj 2007, dhe të inkorporuar, sikurse edhe u vendos, në vendimin e datës 25 korrik 2007 të arbitrit të caktuar nga Gjykata e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, vendim i cili u njoh nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.106, datë 7 nëntor 2008 (në vijim referuar si “Marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim”). Palët e kanë lidhur këtë akt në zbatim të plotë të legjislacionit shqiptar, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është Palë, siç kërkohet nga neni 122.2 i Kushtetutës.

B) Të gjithë termat këtu janë përdorur me të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në marrëveshjet e koncesionit dhe në marrëveshjen e zgjidhjes me mirëkuptim. Marrëveshjet e koncesionit dhe marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim nuk ndryshohen me këtë akt dhe mbeten plotësisht në fuqi, me përjashtim të dorëheqjes së PIA-së nga disa të drejta sipas marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim, siç është rënë dakord këtu në pikën 6, por pa cenuar asnjë të drejtë tjetër të PIA-së.

C) Koncesionari ka përfunduar, sipas marrëveshjeve të koncesionit, ndërtimin e një depozite bregdetare për naftë, nënproduktet e saj dhe produkte të tjera në Gjirin e Vlorës, si dhe infrastrukturën e saj portuale. Terminali dhe infrastruktura portuale u inauguruan më 3 qershor 2009 dhe më 22 qershor 2009, OSHA-ja, me anën e aktit të përcaktimit të kufijve (akti i fundit që kërkohej nga marrëveshjet e koncesionit), i njohu Koncesionarit dhe me anën e këtij akti rikonfirmon përmbushjen e plotë të të gjitha detyrimeve të tij sipas marrëveshjeve të koncesionit, dhe se nuk mund të kërkohen investime të tjera nga ndonjë organ shtetëror në lidhje me marrëveshjen e koncesionit.

D) Gjatë vitit të parë të veprimtarisë së terminalit, OSHA-ja dhe Koncesionari kanë ngritur një numër çështjesh dhe shmangiesh në lidhje me interpretimin e marrëveshjeve të koncesionit dhe zbatimin e tyre praktik, siç rezultojnë nga shkëmbimi i korrespondencave midis Palëve, duke përfshirë letrën e 17 marsit 2010, në të cilën Koncesionari përshkroi situatën që cenonte aktivitetin normal të terminalit.

E) Iniciuar nga disa operatorë dhe OSHA-ja, Autoriteti i Konkurrencës filloi, gjithashtu, me vendimin nr.1, datë 17 shkurt 2010, një hetim mbi veprimtaritë e terminalit. Vendimi i Komisionit u mor më 14 dhjetor 2010, pas seancës dëgjimore përfundimtare të PIA-së, të mbajtur më 13 tetor 2010.

F) OSHA-ja është mbledhur dhe i ka shqyrtuar shqetësimet dhe ankesat e Koncesionarit. OSHA-ja konfirmon politikën e saj të modernizimit të infrastrukturës shqiptare, pjesë e së cilës është terminali PIA, dhe në përgjithësi riafirmon politikën e saj të sigurisë dhe vlerësimit të investimeve private dhe të parimeve të lirisë kontraktore dhe të sipërmarrjes së lirë. OSHA-ja beson se mosmarrëveshjet aktuale janë, gjithashtu, një mundësi për një sqarim tërësor ndërmjet palëve.

G) OSHA-ja konfirmon angazhimin e saj ndaj standardeve të larta ndërkombëtare për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve për produkte të lëngshme, si dhe politikën e saj për të përqendruar këto veprimtari në Vlorë dhe në Porto-Romano, por, për arsye të forta strategjike, ajo tashmë po rishikon politikën e saj për të lejuar, nën kushtet rigorozë të sigurisë dhe të masave të shpëtimit, trajtimin e produkteve të naftës edhe në portin verior të Shëngjinit.

Për këto arsye, si dhe bazuar në sa më sipër, Palët, me dëshirën për të zgjidhur çështjen, janë dakord me interpretimin e përbashkët në vijim të marrëveshjeve të koncesionit, si dhe për masat e treguara këtu më poshtë:

1. Kontratat me afat për kapacitete të dedikuara. OSHA-ja konfirmon se marrëveshjet e koncesionit nuk i vendosin asnjë kufizim parimit të lirisë kontraktore (neni 660 i Kodit Civil), sipas të cilit PIA-ja mbetet me të drejta të plota në marrëdhënien e saj me të gjithë operatorët. Pas shqyrtimit të të gjitha dokumenteve dhe korrespondencave përkatëse, palët konfirmojnë së bashku interpretimin që vijon për detyrimin e PIA-së për të ofruar shërbimet e saj të gjithë operatorët e kualifikuar të interesuar për të operuar me një terminal të pavarur të nivelit mjaft të lartë:

i) Parimet e përgjithshme të nenit 3(a) (Karakteristikat e veçanta të terminalit) dhe detyrimi i PIA-s i parashikuar në nenin 5.7 (Detyrimet e koncesionarit) të Marrëveshjes BOO kanë të bëjnë me depozitimin, që është objekt i kësaj Marrëveshjeje. Këto nene nuk kërkojnë në asnjë mënyrë dhe në fakt as pritjet të kërkojnë, që trajtimi përkatës (i cili nënkupton faktikisht trajtimin e anijeve, trenave dhe kamionëve cisternë), të ofrohet në mënyrë të shkëputur. Me fjalë të tjera, PIA-ja nuk është pikë publike shkarkimi mjetesh cisterne dhe operatorët për të operuar duhet të kenë një marrëveshje kontraktore me PIA-në. Në linjë me kërkesat e nenit 5.7, PIA-ja ka ofruar në treg në të kaluarën dhe do të ofrojë edhe në të ardhmen kapacitetin e vet depozitues, brenda kufijve fizikë të kapacitetit në fjalë. Kur ky kapacitet të jetë kontraktuar plotësisht, PIA-ja nuk duhet të garantojë mundësi të menjëhershme për kapacitete të reja, por ajo do të ofrojë të ndërtojë më shumë kapacitete në linjë me nenin 8.4 të marrëveshjes BOO (d.m.th. PIA-ja duhet të këtë autorizime për të ndërtuar nga OSHA-ja, ajo ka tashmë autorizimet deri në përfundim të fazës së 3-të, dhe një kontratë me afat, si dhe garancitë që sigurojnë mbulimin e investimit dhe që e bën këtë të ketë përfitim). Nëse PIA-ja nuk e përmbush nenin 8.4, do të zbatohet vetëm sanksioni i parashikuar në nenin 8 të marrëveshjes në fjalë.

ii) Është rënë dakord se standardi tip për ofrimin e këtyre shërbimeve është kontrata me afat për kapacitete të dedikuara, edhe me afat të gjatë, si dhe duke siguruar nga klienti edhe garanci financiare ose një kontribut për investimet që do të kryhen nga PIA-ja. PIA-ja dhe klientët e saj janë gjithashtu, të lirë të negociojnë forma të tjera kontrate. OSHA-ja është dakord me arsyet e mira teknike dhe funksionuese që qëndrojnë pas kontratave me afat për kapacitete të dedikuara te terminallet e pavarura dhe se kontratat me afat janë thelbësore për të siguruar efikasitetin e investimit dhe furnizimin e rregullt të tregut. Operatorët do të kontaktojnë PIA-në drejtpërdrejt dhe kohë më parë në mënyrë të mjaftueshme për shërbimet e saj.

iii) Operatorë të kualifikuar, përmendur në nenin 5.7 të marrëveshjes BOO, nënkupton operatorë që kanë një qëndrueshmëri dhe organizim të përshtatshëm për të funksionuar me standardet e aplikueshme jo vetëm në lidhje me sigurinë dhe masat e shpëtimit, por edhe me planifikimin në kohë të operacioneve dhe furnizimeve, si dhe me besueshmërinë tregtare: PIA-ja, për shembull, nuk duhet t'u shërbejë operatorëve që nuk vendosin garanci financiare të kënaqshme për PIA-në, që i kryejnë pagesat me vonesë ose që nuk i kryejnë fare ato, ose që kanë refuzuar të përmbushin kontratat e tyre në të kaluarën. Operatorë të kualifikuar të interesuar për një terminal të pavarur të nivelit mjaft të lartë do të thotë operatorë që pranojnë të punojnë në linjë me standardet e shpëtimit, të sigurisë, të operacioneve dhe të kontratave që kanë përparësi në depozitat bregdetare të pavarura ndërkombëtare.

iv) Shteti ka autorizuar zhvillimin e dy llojeve të infrastrukturës, të cilat u ofrojnë operatorëve zgjidhje alternative: Porto-Romano, i cili, në kuptim dhe brenda kufijve të ligjit nr.9298/04, është një port i hapur publik me tarifa të administruara, ku operatorët mund të ndërtojnë secili depozitat e veta, si dhe terminali PIA në Vlorë, ku operatorët mund të kontraktjnë kapacitetet e tyre (dhe si pasojë t'i përdorin ato si instalime të kontraktuara/ose me qira edhe në kuptimin e marrjes së licencave, sipas kërkesave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe amendamentet dhe ndryshimet e mëvonshme (ligji nr.8450), duke i përqendruar kapitalet e tyre ndërkohë në aktivitetin e tyre tregtar. Me këtë akt sqarohet se, bazuar në versionin ekzistues të ligjit, kërkesa që aplikohet për kapacitet depozitues, sipas të gjitha kërkesave të ligjit nr.8450, është e plotësuar nëse operatorët kanë kontratë me afat me PIA-në për kapacitete të caktuara (për tregti dhe/ose për rezervë sigurie nëse aplikohet), me një kohëzgjatje minimale prej 2 vjetësh (ose me afat më të shkurtër siç mund të caktohet sipas rastit me ligj ose rregullore të tjera). Vetë PIA rregullohet nga ligji nr.9231; ajo nuk është subjekt i ligjit nr.8450 dhe nuk ka përgjegjësi për rezervën e sigurisë (letra datë 7 prill 2005, METE prot.584/1, dhe letra datë 1 qershor 2009, METE prot. 4803).

v) Së fundi, bazuar në kreun 3, seksioni 1 i Kodit Doganor, ligji nr.8450 nuk aplikohet për produktet në regjim të huaj të mbajtura në magazinat doganore ose të lira, dhe për transaksionet që kryhen atje. Ligji nr.8450 zbatohet në tregun e brendshëm (d.m.th. që nga momenti i importimit te doganat). PIA-ja ofron si rregull kapacitete të dedikuara te klientët e saj, përveç kur këta bien

dakord t'i përziejnë kapacitetet. Klientët mund të jenë importues ose tregtarë, të themeluar në Shqipëri ose jashtë saj, me ose pa seli të përhershme sipas rastit (në bazë të nenit 5.7 të Marrëveshjes BOO), si dhe depozitimi mund të bëhet për qëllime importi, depozitimi të përkohshëm dhe rieksporimi (me anije ose nga toka), si dhe për qëllim transferimi të rezervave e produkteve gjendje (qoftë në regjim të huaj ose në qarkullim të lirë) dhe për çdo veprim tjetër që lejohet nga Kodi Doganor.

2. Tarifat. Është rënë dakord se porti Vlorë-1 rregullohet me ligjin nr.9231, siç parashikohet tashmë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.553, datë 1 qershor 2010. Megjithatë, PIA-ja, duke qenë deklaruar port me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.553, duhet të paraqesë për miratim sistemin e tarifave vetëm për aktivitetin e saj portual, të cilin PIA-ja e ka bërë këtë me letrën e saj të datës 26 mars 2010. Letra e PIA-së u aprovua në mbledhjen e OSHA-së më 1.4.2010. Është rënë dakord, gjithashtu, se derisa porti Vlorë-1, sipas ligjit nr.9231, është në përdorim ekskluziv të terminalit (depozitave), PIA-ja nuk është e detyruar të shpallë dhe/ose të paraqesë për miratim tarifatat për shërbimet ndihmëse të depozitimit si trajtimi (ngarkim/shkarkimi) i anijeve ose për shërbime të tjera tregtare që ajo kryen për klientët që kanë kontraktuar kapacitete në terminalin PIA, i cili ndodhet jashtë zonës së portit. PIA-ja do të duhet të paraqesë për miratim modifikimet e ardhshme të tarifave për shërbimet portuale që listohen në letrën e 26 marsit 2010 dhe që u miratuan më 1 prill 2010.

3. Trajtimi direkt. Trajtimi direkt i produkteve (shkarkimi nga anija në kamion/vagon treni ose anasjellas pa përdorur kapacitetin depozitues për shkarkimin e të gjithë ngarkesës) nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje nuk lejohet në asnjë port ose terminal bregdetar në vend. Prandaj operatorët që transportojnë produkte (për import ose eksport) pa bërë rezervimet për depozita në kohën e duhur me PIA-në ose terminalet depozituese të autorizuara, nuk do të lejohen të operojnë në asnjë terminal bregdetar ose port në vend. Megjithatë për periudhën deri më 1 korrik 2011 do të lejohet vetëm trajtimi direkt i bitumit dhe naftës krudo te terminali PIA.

4. Autoriteti i konkurrencës. Autoriteti i konkurrencës është i pavarur nga qeveria, por hetimi i tij në tregun e depozitimit të GLN-së u iniciua edhe nga OSHA-ja. Për më tepër, ligji nr.9231 angazhon të gjitha autoritetet shtetërore dhe neni 6.2(vi) i Marrëveshjes BOO, i inkorporuar në të e ngarkon shtetin dhe qeverinë "Të respektojë plotësisht, si dhe të detyrojë të gjitha autoritetet e tjera kompetente shqiptare të respektojnë plotësisht të gjitha afatet dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje". Për këtë arsye, OSHA-ja do t'i komunikojë Autoritetit të Konkurrencës, jo më vonë se më 20 janar 2011 (duke njoftuar edhe PIA-në), çështjet e mëposhtme, dhe do t'i kërkojë Autoritetit t'i marrë ato në konsideratë për hetimet dhe vendimet në të ardhmen:

i) PIA-ja vepron në një sektor të rregulluar, i cili rregullohet nga ligji nr.9231. Aktiviteti i PIA-së brenda kuadrit të ligjit nr.9231 nuk mund të interpretohet si shkelje e ligjeve të konkurrencës.

ii) Pranohet bashkërisht ndërmjet palëve se interpretimi i neneve 3, 5.7 dhe 8.4 të Marrëveshjes BOO është, siç theksohet në pikën 1 më lart, dhe ky interpretim do të konsiderohet si interpretim autentik i ligjit nga të gjitha organet shtetërore.

iii) Interpretimi i kuptimit të marrëveshjeve të koncesionit ose pjesëve të tyre, në rast mosmarrëveshjeje midis Koncesionarit dhe shtetit, përfaqësuar në këtë rast nga OSHA-ja, parashikohet sipas ligjit nr.9231 të bëhet në juridiksionin ekskluziv të rregulluar në nenin 17 të marrëveshjeve në fjalë.

iv) Miratimi i kontratave të depozitimit me afat si ato që janë në përdorim nga PIA-ja (duke përfshirë këtu kushtet e çmimeve dhe garancitë financiare të lidhura me të), sipas kushteve të vendosura në këtë akt, është thelbësor për menaxhimin e duhur të çdo terminali privat dhe në veçanti të terminalit PIA, si dhe për të nxitur rritjen e dëshiruar të efikasitetit të tregjeve të GLN-së dhe mallrave të tjera të importuara përmes terminalit PIA dhe se, si rrjedhim, ato rritin mirëqenien e përgjithshme në dobi të konsumatorëve dhe i shërbejnë interesit kombëtar.

5. Çështjet e taksës dhe doganës

i) PIA-ja është një ofrues i pavarur shërbimesh industriale të depozitimit dhe trajtimit, objekt të TVSH-së dhe, si e tillë, të gjitha shërbimet e saj do të faturohen me TVSH në shkallën që

aplikohet, duke përfshirë edhe shërbimet e depozitimit dhe të trajtimit që jepen nga PIA-ja për Bankers Petroleum Albania Ltd. Vendimi i zyrës së taksave nr.17693, datë 19 gusht 2010 kundër PIA-së, me anën e këtij akti zgjidhet në favor të PIA-së, ndërsa duke filluar prej këtej e më pas PIA-ja do të lëshojë fatura me TVSH për të gjitha shërbimet e saj.

ii) Pranohet se PIA-ja ka të drejta të plota mbi një kredi TVSH-je prej 697,231,364 lekësh, për t'u ripaguar prej kohësh sipas ligjit nr.9231 dhe Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim, dhe OSHA-ja merr përsipër ta ripaguajë PIA-në me këste prej jo më pak se 39 milionë lekësh në muaj, pa shmangie, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti dhe deri sa e gjithë shuma të jetë ripaguar.

iii) Proceset gjyqësore në lidhje me vendimin doganor 193 të degës së doganës Durrës, me anën e këtij akti zgjidhen në favor të PIA-së dhe në procedimet në vazhdim në gjykatë, doganat do të bien dakord me zgjidhjen në favor të PIA-së.

iv) Një grup i përbashkët pune, me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe METE, është aktualisht duke punuar për hartimin e një rregulloreje të përditësuar në linjë me standardet e BE-së për diferencat sasiore (firot ose humbjet pas shkarkimit të anijeve dhe firot gjatë depozitimit dhe trajtimit) dhe me dokumentacionin e doganave, si dhe, PIA-ja dhe doganat do të koepojnë në këtë çështje me objektiv të përfundojnë më 30 qershor 2011. Që nga fillimi i aktivitetit të PIA-së dhe deri në miratimin e rregulloreve të reja, diferencat sasiore (firot ose humbjet pas shkarkimit të anijeve dhe firot ose humbjet gjatë depozitimit dhe trajtimit) lejohen në terminalin e PIA-së në mënyrën si vijon:

Diferencat e pranuar në matjet sasiore		
Benzinë dhe lëndë djegëse bio të përziera të saj	Gazoil (dizel dhe distilantë të tjerë mesatarë dhe lëndë djegëse bio të përziera të saj)	Lëndë djegëse
Deri në 2%	Deri në 0.3%	Deri në 0.2%

Magazina do të marrë në ngarkim produktet e marra në sasi të matura në tokë nën mbikëqyrjen e doganës. Për sa u përket produkteve në tabelën e mësipërme, diferencat vlerësohen duke aplikuar përqindjet e së njëjtës tabelë mbi sasi të totale të produkteve të ndryshme të bëra dalje nga magazina gjatë periudhës që nga vlerësimi i mëparshëm. Për sa i përket GLN-së, matjet sasiore do të përfshijnë si fazën e lëngët, edhe fazën e gaztë: do të pranohen diferencat brenda kufijve të tolerueshëm të instrumenteve matëse siç janë certifikuar nga autoritetet e metrologjisë. Autorizimi për magazinë të lirë, i PIA-së, do të ndryshohet në përputhje me sa më sipër.

v) OSHA-ja përmes kësaj Marrëveshjeje udhëzon zyrën e përmbarimit Tiranë t'i kthejë PIA-së depozitën prej 25,200.00 eurosh për ekzekutimin e Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim, të depozituar në zyrën e përmbarimit Tiranë, më 8 tetor 2009 (Qeveria Shqiptare u njoftua më 27 tetor 2009, nr. prot.16415).

6. Dorëheqje vullnetare nga disa të drejta dhe zhdëmtime të Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim në lidhje me shkarkimin e produkteve të naftës në Shëngjin

Qeveria, për qëllime të forta strategjike, dëshiron të zhvillojë portin e Shëngjinit; në këtë port do të trajtohen, gjithashtu, edhe produktet e naftës. Për këtë qëllim, ajo i ka kërkuar PIA-së të heqë dorë nga e drejta e saj për marrjen e gjobave, të parashikuara në nenin 5.3(a) të Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim, në lidhje me shkarkimin e produkteve të naftës në Shëngjin, sipas disa kushteve. PIA-ja, në varësi të përmbushjes në kohë dhe me përpikëri brenda afatit të caktuar të të gjitha kushteve të parashikuara këtu (duhet të jetë e qartë se vonesa të kufizuara në rimbursimin e TVSH-së, sipas pikës 5(ii) të këtij akti, nuk do të konsiderohet nga PIA-ja si shkak i mjaftueshëm për të anuluar dorëheqjen), bie dakord me këtë heqje dorë. Në veçanti palët kanë rënë dakord si më poshtë:

i) OSHA-ja konfirmon politikën e saj të palëkundur dhe të përvokueshme për zbatimin në mënyrë të përpiktë dhe të njëtrajtshme të standardeve shqiptare inxhinierike dhe të sigurisë (në

përputhje edhe me nenin 4.2 të Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim) ndaj të gjitha terminaleve të tjera për produkte të lëngshme në vend dhe në veçanti merr përsipër që depozitimi i produkteve të naftës në Shëngjin të bëhet në një terminal modern, të vendosur në një distancë të përshtatshme nga çdo qendër e banuar në përputhje me standardet e sipërpërmendura, dhe që терминаlet në qendrën e qytetit nuk do të lejohen të operojnë më. Për këtë arsye, çdo trajtim në терминаlet ekzistuese brenda qytetit dhe çdo veprimtari tjetër e ndaluar nga Marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim do t'i japë Koncesionarit të drejtën e gjobave të parashikuara në Marrëveshjen e zgjidhjes me mirëkuptim, si dhe nëpërmjet këtij protokoll, OSHA-ja jep autorizimin përfundimtar dhe të përvokueshëm, si dhe instruktoren zyrëre e përbarimit të Tiranës të aplikojë pa formalitete ose kundërshtime të mëtejshme çdonjërin dhe të gjitha gjobat e parashikuara në nenin 5.3(a) të Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim, në rast se verifikohet ndonjë nga rastet e sipërpërmendura.

ii) PIA-ja pranon të heqë dorë vullnetarisht nga të drejtat e saj të gjobave në lidhje me shkarkimin e produkteve të naftës në Shëngjin, siç detajohet në pikën 6, me kusht që, si dhe në varësi të faktit që të gjitha sqarimet, kushtet dhe detyrimet e OSHA-së që përmbahen në këtë protokoll mirëkuptimi dhe marrëveshje, të përmbushen rregullisht dhe në kohën e duhur.

7. Çështje të tjera

i) Në mënyrë që të lehtësohet zhvillimi i fazës 2 dhe fazës 3 të projektit, OSHA-ja do të asistojë PIA-në, si dhe do të nxitë Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH-në ose KRRT-në kombëtare) të zgjasë afatin e lejes së ndërtimit lëshuar PIA-së, për realizimin e projektit me vendimin nr.4, datë 22 maj 2007. Për këtë arsye, brenda gjashtë muajve nga paraqitja e një kërkesë të thjeshtë të PIA-së tek OSHA-ja dhe te KRRTRSH-ja për zgjatjen e lejes ekzistuese të ndërtimit, KRRT-ja kombëtare do të lëshojë vendimin për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit të PIA-së për gjashtëdhjetë muaj të tjerë.

ii) Termocentrali i Vlorës ka ndërtuar një pontil, dhe PIA-ja ka informuar OSHA-në dhe KESH-in me letrën, datë 1 tetor 2007 (prot.7359), që ky vendim është marrë pa ndjekur procedurën e nenit 7 të Marrëveshjes BOT dhe të nenit 8 të Marrëveshjes BOO dhe ka rezervuar të gjitha të drejtat për të mbrojtur interesat e saj. OSHA-ja me anë të këtij dokumenti shpreh besimin e saj se procedurat e kërkuara u ndoqën rregullisht. Termocentrali nuk ka filluar ende të funksionojë dhe OSHA-ja është ende duke konsideruar mundësinë që t'u rekomandojë organeve kompetente që administrojnë aktivitetin e termocentralit të Vlorës, që ky objekt të përdorë shërbimet logjistike të Koncesionarit, sa kohë që ky përdorim do të jetë ekonomikisht i leverdishëm, si dhe do të konsultohet me palët e tjera të përfshira në këtë çështje përpara arritjes së një qëndrimi përfundimtar.

OSHA-ja vlerëson se ndryshimi i rëndësishëm në infrastrukturë i vendosur nga procesi politik dhe administrativ i filluar më 1999-ën për të identifikuar infrastrukturën e specializuar në Shqipëri për produktet e rrezikshme, dhe i përfunduar me inaugurimin e terminalit PIA dhe Porto-Romano në 2009-ën, do të sjellë ndryshime në treg, të cilat konsiderohen pozitive nga OSHA-ja. Në të vërtetë ato janë një pjesë e rëndësishme e procesit të modernizimit të ekonomisë shqiptare, që kërkojnë një planifikim të avancuar të logjistikës dhe më shumë kapital. OSHA-ja do të përqendrojë tashmë veprimtarinë e saj në inkurajimin e operatorëve për t'u përshtatur me situatën e re dhe për të planifikuar mjaft kohë më parë nevojat e tyre logjistike, si dhe pranon rolin thelbësor që PIA-ja po luan në interesin publik.

Në përgjithësi palët janë dakord që këto sqarime dhe marrëveshje do të zgjidhin dallimet ndërmjet palëve, dhe do zëvendësojnë dhe anulojnë çdo komunikim të mëparshëm të kundërt me to, duke përfunduar kështu procesin e filluar më 17 mars 2010, sipas nenit 17 të Marrëveshjeve të Koncesionit, me kusht që të gjitha detyrimet të jenë zbatuar rregullisht, si dhe OSHA-ja të asistojë dhe të mbështesë PIA-në në të gjitha proceset gjyqësore të organeve shtetërore kundër PIA-së.

Ky akt rregullohet sipas nenit 17 të Marrëveshjeve të Koncesionit dhe në përgjithësi nga dispozitat përkatëse të Marrëveshjeve të Koncesionit dhe Marrëveshjes së zgjidhjes me mirëkuptim. Ai aprovohet nga OSHA-ja dhe pasi nënshkruhet rregullisht nga Palët, në linjë me procedurën e ndjekur për Marrëveshjen e zgjidhjes me mirëkuptim, do t'i nënshtrohet dhe do hyjë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
Ilir Meta

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

LA PETROLIFERA ITALO RUMENA S.p.A. DHE LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE
SHA
**Drejtor Administrativ
Guido Ottolenghi**

VENDIM
Nr.111, datë 26.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE,
QË TRANSFEROJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E
DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, togfjalëshi “të Shëngjinit”, kudo ku është përdorur, shfuqizohet.
 2. Në portin e Shëngjinit të fillojë veprimtaria e përpunimit të anijeve, që trajtojnë produkte dhe nënprodukte të naftës, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
 3. Përpunimi i anijeve, që trajtojnë produkte dhe nënprodukte të naftës në këtë port, të realizohet në përmbushje të standardeve shqiptare inxhinierike dhe ato të depozitohen në një terminal modem, të vendosur në distanca të përshtatshme me objektet publike ose private.
 4. Për arsye sigurie, distanca minimale e terminalit depozitues nga pika e shkarkimit në këtë port të jetë jo më pak se 2 500 metra lineare.
 5. Terminali depozitues të respektojë kushtet e sigurisë së jashtme, të brendshme, normat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe kushtet e normat teknike në fuqi.
 6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.112, datë 17.2.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.411, DATË 29.8.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË ADMINISTRIMIN E ZYRËS
QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË ZYRAVE
TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, KORÇË DHE
DURRËS”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.448, DATË 16.6.2005 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të nenit 2/2 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titullin dhe tekstin e vendimit nr.411, datë 29.8.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- fjalët “... Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ...”, “... Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë ...”, “Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë ...” dhe “... Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës ...”, zëvendësohen me fjalët “... Ministrisë së Drejtësisë, në përdorim të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ...”.

2. Në titullin dhe tekstin e vendimit nr.448, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- fjalët “...Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ...”, zëvendësohen me “... Ministrisë së Drejtësisë, në përdorim të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.113, datë 17.2.2011

PËR PARANDALIMIN E TRANSMETIMIT TË HIV/AIDS-IT DHE PËR KUJDESIN,
KËSHILLIMIN DHE TRAJTIMIN E PERSONAVE QË JETOJNË ME HIV/AIDS NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT, TË RIEDUKIMIT, INSTITUCIONET E TRAJTIMIT
MJEKËSOR, INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË PËRKUJDESIT SOCIAL, BURGJET
DHE VENDET E PARABURGIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Ofrimi në mënyrë të barabartë i programeve të parandalimit dhe të kujdesit për personat që jetojnë me HIV/AIDS, me ato për personat e painfektuar.

2. Konfidencialiteti, mosstigmatizimi e mosdiskriminimi i personave që jetojnë me statusin e HIV/AIDS-it.

3. Mospërjashtimi i personave që jetojnë me HIV/AIDS nga rrjeti i institucioneve të arsimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, për shkak të statusit të tyre HIV/AIDS.

4. Personat me status HIV/AIDS trajtohen në një mënyrë të drejtë, të përshtatshme dhe humane.

II. PARANDALIMI NË SHKOLLA

1. Fëmijët e moshës parashkollore/nxënësit/studentët me HIV/AIDS kanë të drejtë të ndjekin institucionet arsimore përkatëse, për sa kohë janë të aftë ta vazhdojnë atë.

2. Çdo nxënës, prind apo kujdestar i tij, student, edukator ose personel tjetër, mund t'ia zbulojë vullnetarisht statusin e tij HIV/AIDS institucionit apo punëdhënësit.

3. Drejtuesi i institucionit mirëkupton zbulimin vullnetar të statusit HIV/AIDS nga nxënësit, prindërit apo kujdestarët e tyre, studentët, edukatorët ose personeli tjetër, duke siguruar konfidencialitetin për informacione të tilla, si dhe mosdiskriminimin.

4. Çdo personi që ka marrë informacion lidhur me kushtet mjekësore të një nxënësi/studenti apo pjesëtari të personelit arsimor me status HIV/AIDS, i kërkohet ta ruajë këtë informacion në mënyrë konfidenciale.

5. Një nxënës/student që jeton me HIV/AIDS, nuk paraqet rrezik të shtuar për fëmijët apo personat e tjerë. Megjithatë, nëse ka rrethana të caktuara, në të cilat rreziku mendohet të rritet, prindërit, kujdestarët dhe mësuesit mund të kërkojnë takim me drejtuesin e strukturës lokale të shëndetit publik, në mënyrë që të përcaktohet shkalla e rrezikut shëndetësor të fëmijët e tyre. Në rastet e vlerësimit prezent të rrezikut, informohet drejtuesi i institucionit, në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për të siguruar shëndetin e fëmijëve të tjerë dhe pjesëtarëve të personelit arsimor.

6. Programet edukative për HIV/AIDS-in përfshihen në të gjithë rrjetin e institucioneve arsimore. Edukimi, përshtatur sipas moshës, lidhur me HIV/AIDS-in, duhet të jetë pjesë e kurrikulave.

7. Informacioni për një parandalim të përshtatshëm përfshin:

a) ofrimin e informacionit për abstinencën nga marrëdhëniet seksuale, përdorimin e prezervativit, besnikërinë ndaj partnerit, sigurimin e trajtimit të përshtatshëm mjekësor për infeksionet seksualisht të transmetueshme, shmangien e kontaktit me gjakun dhe aplikimin e masave universale lidhur me ndihmën e parë;

b) sigurimin e informacionit për rolin e drogave, abuzimin seksual dhe përdhunimin, rolin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme në transmetimin e HIV/AIDS-it, si dhe krijimin e mundësisë që këto çështje të jenë të qarta e të kuptueshme.

8. Informacioni i mësipërm ka si qëllim:

a) të inkurajojë nxënësit/studentët që të përdorin kujdesin shëndetësor, këshillimin dhe shërbimet e mbështetjes, të ofruara në komunitet nga strukturat shtetërore, organizatat etj. (duke përfshirë shërbimet e lidhura me kujdesin ndaj shëndetit riprodhues dhe parandalimin e trajtimit e infeksioneve seksualisht të transmetueshme);

b) të ndihmojë kultivimin dhe mundësimin e një mjedisi e të një kulture të mosdiskriminimit ndaj personave me HIV/AIDS, duke rritur ndërgjegjësimin ndaj paragjykimit dhe stereotipave të lidhur me HIV/AIDS-in.

9. Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, siguron zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe marrjen e masave të përgjithshme në institucionet arsimore, në mënyrë që të eliminohet rreziku i përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme nëpërmjet gjakut,

duke përfshirë edhe infektimin nga HIV/AIDS-i. Masat e përgjithshme të parandalimit përfshihen në shtojcën 1.

10. Të gjitha institucionet arsimore, në bashkëpunim me strukturat lokale të shëndetit publik, sigurojnë trajnime lidhur me ndihmën e parë për nxënësit/studentët, mësuesit dhe punonjësit e institucionit. Gjithashtu, sigurohen edhe mjetet mbrojtëse të përshtatshme, duke përdorur pajisjet e përcaktuara në shtojcën 2.

11. Nëse s'mund të sigurohet një ndihmë e parë e vërtetë, atëherë është mirë që në mjedisin shkollor të ketë mjete rrethore për të ofruar ndihmën e shpejtë.

12. Mjetet e ndihmës së shpejtë vendosen në një vend të caktuar dhe të dukshëm në shkollë, në mënyrë që të jenë të përdorshme në çdo kohë. Përbërësit e kutisë së ndihmës së shpejtë kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe të herëpashershme nga një pjesëtar i personelit arsimor. Kutia e ndihmës së shpejtë në shkollë kontrollohet një herë në muaj nga strukturat lokale të shëndetit publik, për të vlerësuar përbërjen dhe afatin e skadencës së medikamenteve mjekësore. Pajisjet e ndihmës së shpejtë merren në të gjitha veprimtaritë e shkollës dhe transportohen kudo që të jetë veprimtaria. Nxënësit/studentët dhe personeli arsimor marrin informacionin e përshtatshëm për mënyrat e transmetimit të HIV/AIDS-it, përdorimin e mjeteve të ndihmës së shpejtë dhe aplikimin e masave universale parandaluese.

13. Institucioni arsimor merr të gjitha masat e nevojshme për të shmangur refuzimin për të studiuar me një nxënës/student, për të punuar apo për të pasur mësues një person me status HIV/AIDS, apo të perceptuar me HIV/AIDS, duke siguruar një informacion të saktë e të përshtatshëm për HIV/AIDS-in për të gjithë pjesëtarët e personelit arsimor, nxënësit/studentët dhe prindërit ose kujdestarët e tyre.

III. PARANDALIMI I HIV/AIDS-IT NË BURGJE DHE INSTITUCIONET E RIEDUKIMIT

1. Ofrimi i shërbimeve të parandalimit, kujdesit, trajtimit dhe mbështetjes për HIV/AIDS-in, për të burgosurit/paraburgosurit, është i njëjtë me atë të personave në komunitet jashtë mjediseve të burgut.

2. Personat që vuajnë dënimin në mjediset e burgut kanë këto të drejta:

a) Të kryejnë falas testimin për HIV/AIDS dhe të këshillohen para dhe pas testimit nga personeli i trajnuar për këtë qëllim.

b) Të japin pëlqimin e tyre dhe të informohen përpara kryerjes së testimit për HIV/AIDS-in.

c) Të mos izoloohen për shkak të statusit të tyre HIV pozitiv dhe të mos trajtohen në mënyrë të atillë që të zbulohet statusi i tyre HIV.

ç) Të burgosurit/paraburgosurit që jetojnë me HIV/AIDS nuk janë të ndaluar nga pjesëmarrja në programet e ofruara, puna apo veprimtari sociale për shkak të statusit të tyre HIV pozitiv.

d) Konfidencialiteti për statusin e tyre HIV pozitiv të jetë i garantuar, i ruajtur mirë dhe i aksesueshëm vetëm nga personeli mjekësor.

dh) Informacioni mjekësor dhe të dhënat nuk duhet të ndahen me të tjerët, pa pëlqimin e personit HIV pozitiv.

3. Parandalimi i përhapjes së infeksionit HIV të të burgosurit/paraburgosurit dhe personeli i burgut/paraburgimit realizohet nëpërmjet:

a) trajnimeve të vazhdueshme, fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit për parandalimin e infektimit nga HIV/AIDS-i, jo vetëm me të burgosurit/paraburgosurit, por, gjithashtu, edhe me personelin shëndetësor, të shërbimeve sociale, si dhe me personelin e sigurisë në burgje/vendet e paraburgimit;

b) prodhimin të materialeve informuese për parandalimin e infektimit nga HIV/AIDS-i;

c) hartimit të manualeve të trajnimit/kurrikulave për personelin e shërbimit shëndetësor dhe social në burgje;

ç) identifikimit dhe trajnimit të edukatorëve e përfshirjen e tyre në veprimtaritë e parandalimit të infektimit nga HIV/AIDS-i;

d) sigurimit të kondomëve dhe materialeve të tjera të seksit të sigurt nga ana e institucioneve të burgjeve/paraburgimit, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë të burgosurit/paraburgosurit;

dh) përfitimit të shërbimeve për kujdesin dhe parandalimin e HIV/AIDS-it, si dhe shërbime për varësinë ndaj drogës, ashtu sikurse edhe pjesa tjetër e popullatës;

e) ofrimit të terapisë zëvendësuese me metadon ose terapi të tjera, të miratuara nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, për të burgosurit/paraburgosurit që kanë varësi nga drogat.

4. Të burgosurit/paraburgosurit përfitojnë të gjitha shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor pa pagesë.

5. Kujdesi shëndetësor ofrohet pa diskriminim dhe në nivel të barabartë me atë në komunitet, duke përfshirë referimin dhe aksesin në shërbimet shëndetësore të komunitetit, kur është e nevojshme.

6. Të burgosurit/paraburgosurit me status HIV pozitiv kanë akses për terapinë antiretrovirale, sipas indikacioneve mjekësore.

7. Institucionet shëndetësore në burgje/vendet e paraburgimit në bashkëpunim me shërbimet e sëmundjeve infektive, sigurojnë dhe ofrojnë ekzaminimet mjekësore specifike për personat e diagnostikuar me HIV pozitiv.

8. Personat që jetojnë me HIV/AIDS dhe kanë infeksione oportuniste ose infeksione të tjera, që kanë lidhje me HIV/AIDS-in, marrin trajtim në institucionet shëndetësore të burgjeve/vendeve të paraburgimit.

9. Nëse një i burgosur, refuzon terapinë zëvendësuese apo ndonjë trajtim tjetër, kjo situatë nuk duhet të përdoret si arsye për masa disiplinore ose ndëshkuese ndaj tij.

10. Vazhdueshmëria e një jete të shëndetshme dhe programet edukative për HIV/AIDS-in implementohen në rrjetin e institucioneve të riedukimit nëpërmjet:

a) sigurimit të informacionit për HIV/AIDS-in dhe zhvillimit të aftësive të përshtatshme jetësore për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS-it;

b) sigurimit të informacionit për një parandalim të përshtatshëm, duke përfshirë abstinencën nga marrëdhëniet seksuale, përdorimin e prezervativit, besnikërinë ndaj partnerit, sigurimin e trajtimit të përshtatshëm mjekësor për infeksionet seksualisht të transmetueshme, shmangien e kontaktit me gjakun dhe aplikimin e masave universale lidhur me ndihmën e parë;

c) sigurimit të informacionit për rolin e drogave, abuzimit seksual dhe përdhunimit, infeksioneve seksualisht të transmetueshme në transmetimin e HIV/AIDS-it, si dhe krijimit të mundësisë që këto çështje të jenë të qarta e të kuptueshme;

ç) ofrimit të kujdesit shëndetësor, këshillimit dhe shërbimet e mbështetjes (duke përfshirë shërbimet e lidhura me kujdesin ndaj shëndetit riprodhues, si dhe parandalimin e trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme).

IV. PARANDALIMI NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE TË PËRKUJDESIT SOCIAL

1. Ofrimi i shërbimeve të parandalimit, kujdesit, trajtimit dhe mbështetjes për HIV/AIDS-in, për individët në institucionet e përkujdesit social, është i njëjtë me atë të personave në komunitet jashtë mjediseve të këtyre institucioneve.

2. Parandalimi i përhapjes së infeksionit HIV, në institucionet e përkujdesit social, përfshin:

a) zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe marrjen e masave nga institucionet e përkujdesit social, për eliminimin e rrezikut të përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme nëpërmjet gjakut, përfshirë edhe infektimin HIV, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 1;

b) trajnime të vazhdueshme, fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në parandalimin e HIV/AIDS-it, për personat rezidentë në këto institucione, si dhe për personelin shëndetësor të shërbimeve sociale. Kryerja e këtyre trajnimeve realizohet nga strukturat e shëndetit publik lokal, në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit Social Shtetëror;

c) Prodhimin e materialeve informuese për parandalimin e HIV/AIDS-it;

ç) Hartimin e manualeve të trajnimit/kurrikulave, në bashkëpunim me personelin e shërbimit shëndetësor dhe social;

d) Edukimin dhe informimin lidhur me HIV/AIDS-in, në mënyrë të saktë e shkencore, duke përdorur fjalë dhe shprehje të kuptueshme.

3. Personave rezidentë në institucionet e përkujdesit social u ofrohen shërbime në lidhje me kujdesin, parandalimin e HIV/AIDS-it, si dhe shërbime të tjera, sipas indikacioneve mjekësore.

4. Personat rezidentë në institucionet e përkujdesit social dhe me status HIV pozitiv kanë akses për terapinë antiretrovirale, sipas indikacioneve mjekësore.

5. Institucionet e përkujdesit social, në bashkëpunim me shërbimet e sëmundjeve infektive, bashkërendojnë ekzaminimet mjekësore specifike për personat e diagnostikuar HIV pozitiv.

V. PARANDALIMI NË INSTITUCIONET E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR

1. Parandalimi i përhapjes së infeksionit HIV, në institucionet shëndetësore, përfshin:

a) zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe marrjen e masave nga institucionet shëndetësore, për eliminimin e rrezikut të përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme nëpërmjet gjakut, përfshirë edhe infektimin HIV, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcat 1 dhe 3;

b) trajnime të vazhdueshme, fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në parandalimin e HIV/AIDS-it, për personelin shëndetësor;

c) prodhimin e materialeve informuese për parandalimin e HIV/AIDS-it;

ç) hartimin e manualeve të trajnimit/kurrikulave për personelin e shërbimit shëndetësor;

d) edukimin dhe informimin lidhur me HIV/AIDS-in, në mënyrë të saktë dhe shkencore.

2. Masat, që duhen marrë në rast ekspozimi ndaj virusit HIV, në institucionet shëndetësore:

a) Në rastet e ekspozimit të mundshëm profesional ndaj virusit HIV/AIDS, në institucionet shëndetësore, raportohet rasti te drejtuesi i institucionit dhe shërbimi i sëmundjeve infektive. Testimi për HIV/AIDS ofrohet në qendrat për këshillim e testim vullnetar dhe shkalla e ekspozimit vlerësohet nga mjeku infeksionist në shërbimet e sëmundjeve infektive.

b) Terapia me antiretroviral, sipas indikacioneve mjekësore, ofrohet në shërbimin infektiv, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

c) Këshillimi para dhe pas testimit kryhet vetëm nga personeli i trajnuar për këtë qëllim në qendrat për këshillim dhe testim vullnetar, si dhe në strukturat lokale të shëndetit publik.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

SHTOJCA 1 MASA UNIVERSALE

1.1 Baza për mbrojtjen e një aplikimi të qëndrueshëm të masave parandaluese universale, çon në supozimin se në një ekspozim potencial ndaj gjakut apo lëngjeve të trupit, me një person të infektuar, të gjithë njerëzit janë potencialisht të infektuar me HIV. Gjaku, plagët e hapura, të çarat në lëkurë, mund të bashkohen me lëngjet e tjera të trupit (si lotët, pështyma, urina, të vjellat etj.) dhe mund të trajtohen si infeksion potencial.

a) Gjaku, sidomos në rrjedhje të mëdha, si për shembull rrjedhje e gjakut nga hundët apo një njollë gjaku duhet të trajtohet me shumë kujdes.

b) Lëkura e ekspozuar aksidentalisht ndaj gjakut duhet të lahet menjëherë me sapun dhe ujë të rrjedhshëm.

c) Të gjitha plagët e gjakosura, të çarat në lëkurë duhet të pastrohen menjëherë me ujë të rrjedhshëm dhe antiseptikë të tjerë.

d) Nëse ka një incident kafshimi ku lëkura është çarë, plaga duhet të pastrohet me ujë të rrjedhshëm, të thahet, të trajtohet me antiseptikë dhe të mbulohet me një copë të papërshkueshme nga uji.

e) Gjaku që del në fytyrë (mukoza apo membrana e syve, e hundës apo e gojës) duhet të pastrohet me ujë të rrjedhshëm për të paktën tri minuta.

f) Masat e përshtatshme duhet të merren për shërimin e infeksioneve.

1.2 Të gjitha plagët e hapura, të çarat në lëkurë duhet të mbulohen tërësisht dhe në mënyrë të sigurt me një copë të papërshkueshme nga uji, joporoze, pra që mos të ketë mundësi të ekspozohet ndaj gjakut.

1.3 Pastrimi dhe larja duhet të bëhet gjithmonë me ujë të rrjedhshëm dhe jo ujë të ndenjtur. Kur uji i rrjedhshëm nuk është e mundur të sigurohet, mund të përdoret uji i rezervuarit. Shkollat që nuk kanë ujë të rrjedhshëm duhet të mbajnë pajisje me volum 25 litra, për ta përdorur specifikisht në raste emergjencash. Ky ujë mund të ruhet i freskët për një periudhë të gjatë kohe duke e klorifikuar.

1.4 Të gjithë personat në kontakt me plagët e hapura, të çarat në lëkurë, duhet të veshin doreza plastike për të eliminuar rrezikun e infektimit me HIV/AIDS. Gjakderdhja mund të ndalohet duke përdorur materiale thithëse si shami apo copa. Nëse një sipërfaqe është ndotur me lëngje trupore dhe sekrecione që mund të jenë përzier me gjakun (për shembull: lot, pështymë, të vjella, urinë etj.) duhet të pastrohet me ujë të rrjedhshëm dhe të ftohtë, tretësirë klori (1:10), letër apo lecka. Personi që bën pastrimin duhet të veshë doreza mbrojtëse dhe të mbajë çantë plastike.

1.5 Materialet e gjakut të infektuar duhet të futen në një çantë plastike dhe të digjen.

1.6 Tualeti dhe pajisjet që ndodhen në të duhet të lahen me ujë të rrjedhshëm.

1.7 Instrumentet e infektuara, gërshërët për shembull, duhet të lahen me tretësirë klori të paktën një orë përpara se të ripërdoren.

1.8 Shiringat dhe aget nuk duhet të ripërdoren.

SHTOJCA 2

PËRBËRËSIT E REKOMANDUAR PËR NDIHMËN E PARË TE FËMIJËT

Mjetet e mëposhtme shërbejnë si mjetet e nevojshme të ndihmës së shpejtë në marrjen e masave parandaluese në nivel universal. Çdo institucion duhet t'i ketë këto mjete:

- Doreza latex	100
- Doreza shtëpie	100
- Pambuk	1 top
- Klor	1 bidon 4 litërsh
- Garza	1 top
- Çantë plastike	100
- Banda ndihme	100
- Kapëse gjuhe	20
- Gërshërë	2 palë

a) Doreza prej lateksi, me një përdorim;

b) Doreza shtëpie me një përdorim (për shembull për të mbledhur një gotë të thyer);

c) Materiale thithëse, dezinfektantë, fasha, pambuk;

d) Tretësirë klori në raport 1:10, për ta përdorur si dezinfektant;

e) Qese jo të çara, në rastet kur dorezat nuk janë të pranishme.

SHTOJCA NR.3

MASA PARANDALUESE TË KONTROLLIT TË INFEKSIONIT NË KUJDESIN SHËNDETËSOR ELEMENTET KYÇE	
<p>1. Higjiena e duarve Teknika të përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Larja e duarve (40-60 sek): lagni duart dhe shkumëzohjini ato me sapun; fërko gjithë sipërfaqet; shpëlajni ato dhe thaji me letër ose peshqir njëpërdorimësh; përdor letrën për të mbyllur rubinetin. - Pastrimi me solucion i duarve (20-30 sek): përdor solucion të mjaftueshëm për të mbuluar gjithë sipërfaqen e duarve; fërkoji deri sa të thahen. <p>Indikacione të përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpara dhe pas çdo kontakti direkt me pacientë ose midis tyre edhe kur janë veshur doreza. - Menjëherë pas heqjes së dorezave. - Përpara se të përdoret një procedurë invazive - Pas prekjës së gjakut, lëngjeve trupore, sekrecioneve, ekskrecioneve, lëkurës së dëmtuar, edhe kur dorezat janë përdorur. - Gjatë kujdesit të pacientit, kur kalojmë nga një sipërfaqe e kontaminuar në një sipërfaqe të pastër. - Pas kontaktit të objekteve të pacientit. <p>2. Dorezat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vishen kur preket gjak, lëngje trupore, sekrecione, ekskrecione, membranë mukoze, lëkurë e dëmtuar. - Ndërrimi i tyre pas çdo procedure, pas kontaktit të sipërfaqeve të kontaminuara të të njëjtit pacient. - Heqja e tyre pas përdorimit, përpara se të preken sende të pakontaminuara, dhe përpara se të shkohet te pacientët e tjerë. Të bëhet higjiena e duarve direkt pas heqjes së dorezave. <p>3. Mbrojtje e fytyrës (sy, hundë dhe gojë)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdor maskë kirurgjikale dhe mbrojtëse të syve (syze, maskë plastike) për të evituar kontaminimin e mukozës së syve, hundës e gojës me piklat që mund të formohen nga derdhjet e lëngjeve të ndryshme trupore. <p>4. Përparëse</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorni për të mbrojtur lëkurën dhe veshjen nga derdhjet e ndryshme të lëngjeve trupore. - Hiqini përparëset e ndotura menjëherë pas përfundimit dhe kryeni higjienën e duarve. <p>5. Parandalimi i shpimeve me age Trego kujdes kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mban dhe përdor age apo instrumente të tjera prerës; - pastron instrumentet e përdorura; - hedh aget e përdorura. 	<p>6. Higjiena respiratore dhe etika e kollës Personat me simptoma respiratore duhet të marrin masat për kontrollin e burimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të mbulohet hunda dhe goja gjatë kollitjes/teshtitjes me shami apo maskë, hidhni maskën apo shaminë pas përdorimit dhe lajini duart. <p>Mjediset e kujdesit mjekësor duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosin pacientët me simptoma respiratore febrile të paktën 1m larg pacientëve të tjerë në zonën e pritjes (ambientet e përbashkëta), nëse është e mundur. - Vendosni postera që në hyrjen e mjedisëve të kujdesit mjekësor duke i udhëzuar pacientët me simptoma respiratore që të praktikojnë higjienën respiratore dhe etikën e kollës. - T'u bëhet e mundur gjithë pacientëve me sëmundje respiratore febrile të kenë mjetet e nevojshme për higjienën e duarve dhe atë respiratore. <p>7. Pastrimi i mjedisit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdor procedura të përshtatshme për pastrimin në rutinë dhe dezinfektimit të ambientit dhe të sipërfaqeve të prekshme. <p>8. Asgjësimi i mbeturinave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Siguro menaxhim të sigurt të mbeturinave - Trajtimi i mbeturinave të kontaminuara me gjak, lëngje trupore, sekrecione dhe ekskrecione, në përputhje edhe me rregulloren lokale. - Indet humane dhe mbeturinat laboratorike duhet të trajtohen gjithashtu si mbeturina spitalore. - Hidhni pajisjet me një përdorim në mënyrë të sigurt. <p>9. Pajisjet për kujdesin e pacientit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbajtja dhe përpunimi i pajisjeve të ndotura me gjak, lëngje trupore, sekrecione dhe ekskrecione në atë mënyrë që të parandalojë ekspozimin, kontaminimin e veshjeve dhe transferimin e patogjenëve te pacientët të tjerë ose në mjedis. - Pastro, dezinfekto dhe rifuti në proces pajisjet jo me një përdorim në mënyrë të përshtatshme përpara se të përdoren te një pacient tjetër.

VENDIM
Nr.114, datë 2.2.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nënndarja “xv. Shërbimi i ruajtjes me rojë private”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.115, datë 17.2.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS LEKAJ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lekaj të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 628 (gjashtëqind e njëzet e tetë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lekaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr. rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit	Lloji i transferimit
1-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12, 13	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
21-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
25-44	Shërbime funerale	Në pronësi
45-48, 50-53, 55-59, 61-64, 66-78, 555	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
49, 54, 60, 65, 79, 81, 83, 85, 88, 91, 93, 98, 100, 107, 110, 112, 115	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
189-543	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
544-554, 556-628	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM**Nr.116, datë 17.2.2011**

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3, 10 e 12 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me numër rendor 1118 (një mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) - 1128 (një mijë e njëqind e njëzet e tetë), e cila përbëhet nga 90 (nëntëdhjetë) fletë.

2. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.119, datë 17.2.2011

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FONDACIONIT “REFUGEES INTERNATIONAL”,
NË KUJTIM TË VEPRËS SË DIPLOMATIT TË SHQUAR AMERIKAN RICHARD
HOLBROOKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin 01120 “Përfaqësitë diplomatike dhe shërbimi konsullor”, t’i shtohet fondi prej 20 000 (njëzet mijë) dollarësh amerikanë, kundërvlera në lekë, për dhënie ndihme financiare fondacionit “Refugees International”, në kujtim të veprës së diplomatit të shquar amerikan Richard Charles Albert Holbrooke, fond, i cili do të përdoret për qëllime humanitare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.121, datë 17.2.2011

**PËR MËNYRAT E USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NGA DREJTORITË E
ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË QARQE DHE ZYRAT E
MENAXHIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË KOMUNA DHE/OSE BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 9 dhe 12 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS (DAMT), NË KËSHILLIN E QARKUT

1. DAMT-ja funksionon si strukturë administrative e këshillit të qarkut, e përbërë nga drejtori dhe dy sektorë.

1.1. Drejtori i DAMT-së përgjigjet para këshillit të qarkut dhe strukturave përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për zbatimin e dispozitave të legjislacionit për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

1.2. Në përbërje të DAMT-së janë:

a) Sektori i administrimit të tokës, në përbërje të të cilit janë vetëm zyrat e administrimit të tokës në nënndarjet (rrethet) e qarkut.

Sektori i administrimit të tokës në DAMT përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e tokës bujqësore, si dhe të kategorive të tjera të resurseve të përcaktuara në ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të dispozitave vijuese të këtij vendimi, si dhe akteve të tjera nënligjore për administrimin e tokës;

b) Sektori (Inspektorati) i Mbrojtjes së Tokës (IMT), që ka për detyrë dhe përgjigjet për zbatimin e dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, në vendimin nr.80, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”, si dhe në aktet e tjera nënligjore për mbrojtjen e tokës.

2. Funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së DAMT-së në rreth kryhen sipas një ndarjeje, që përcaktohet nga drejtori i DAMT-së.

3. Numri i punonjësve të administrimit të tokës për çdo zyrë të DAMT-së në rreth, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të DAMT-së, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në varësi me madhësinë e çdo rrethi, miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e kryetarit të këshillit të qarkut.

4. Drejtori i DAMT-së dhe punonjësit e zyrave të DAMT-së në nënndarjet e qarkut, të caktuar për administrimin e tokës, janë pjesë e organikës së punonjësve të përcaktuar nga ligji, si funksion i deleguar, i detyrueshëm, i Këshillit të Ministrave.

5. Drejtori i DAMT-së organizon punën dhe përgjigjet për kualifikimin tekniko-profesional të punonjësve të DAMT-së, nëpërmjet trajnimeve periodike të tyre dhe informimeve për standardet bashkëkohore në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DAMT-SË PËR MBAJTJEN, RUAJTJEN DHE PËRTËRITJEN E DOKUMENTACIONIT KADASTRAL MBI TOKËN

1. DAMT-ja, për realizimin e funksionit të saj si kadastër e shumëqëllimshme, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues që disponohet pranë saj, pavarësisht nga koha e krijimit të tij dhe që përbëhet nga:

a) librat e tokës dhe librat e ngastrave;

b) planimetri të ndryshme kadastrale;

c) çdo hartë kadastrale dhe topografike ose plansheta: 1:1000, 1:2500, 1:5000, 1:10000 dhe 1:25000, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi disponohen nga DAMT-ja;

ç) dokumente, në të cilat evidentohen pronësitë, private apo shtetërore (publike), të periudhës para hyrjes në fuqi të ligjit nr.108, datë 29.8.1945 “Për reformën agrare”, në çdo rast kur këto dokumente janë ruajtur dhe ekzistojnë në arkivin e DAMT-së;

d) dokumente, në të cilat janë regjistruar, evidentuar apo pasqyruar të dhëna dhe tregues për tokën bujqësore, si dhe të kategorive të resurseve të tjera të periudhës nga 29.8.1945 deri në 19.7.1991;

dh) dokumente, që kanë për objekt fondin e tokës bujqësore dhe të kategorive të resurseve të tjera, në të cilat evidentohen ose pasqyrohen tregues dhe të dhëna për ndryshimet e kalimet e tokave, si dhe të dokumentacionit të ndarjes së tokës dhe krijimit të titujve të pronësisë mbi të, kur mbajtja dhe ruajtja e këtij dokumentacioni nga DAMT-ja (ish-zyra e kadastrës) është përcaktuar me akte ligjore ose nënligjore;

e) akte (vendime) të organeve apo strukturave kompetente, të përcaktuara në ligj, nëpërmjet të cilave janë realizuar ndryshime apo kalime të tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera ose anasjellas;

ë) librat (pasqyrat) e treguesve të studimit të bonitetit të tokave bujqësore dhe të kategorizimit të tokës sipas bonitetit.

2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, që në periudhën para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ka qenë pjesë e dokumentacionit zyrtar të DAMT-së (ish-zyrës së kadastrës në rreth), por që, për shkaqe të ndryshme, evidentohet se ka dalë nga këto zyra dhe iu është vënë në dispozicion institucioneve shtetërore, kur është e mundur tërhiqet prej tyre nga DAMT-ja, si fotokopje të vërtetuara me origjinalin.

2.1. Rimarrja e këtij dokumentacioni, në cilësinë e dokumentacionit zyrtar të DAMT-së, bëhet me procesverbal, që nënshkruhet nga drejtori dhe dy specialistë të DAMT-së, nga njëra anë, dhe dorëzuesi i këtij dokumentacioni, nga ana tjetër.

2.2. Në procesverbal shënohen rrethanat, shkaqet dhe koha kur ky dokumentacion ka dalë nga ish-zyra e kadastrës së rrethit.

2.3. Procesverbali i bashkëlidhet dokumentacionit që rimerret nga DAMT-ja dhe inventarizohet e ruhet në arkiv, në mënyrë të përhershme.

3. DAMT-ja merr masa për përtëritjen e dokumentacionit kadastral ekzistues, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu, që rezulton me dëmtime fizike, si rezultat i kohëzgjatjes së përdorimit të tij dhe i faktorëve të tjerë, duke ruajtur në arkiv origjinalin bashkë me kopjen e përtërirë, në mënyrë të përhershme.

III. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DAMT-SË PËR KRIJIMIN E DOKUMENTACIONIT TË RI KADASTRAL DHE KRIJIMIN E BAZËS SË SISTEMIT TË INFORMACIONIT PËR TOKËN

1. DAMT-ja bashkërendon veprimtaritë me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komunë dhe/ose bashki, organizon punën për krijimin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të tjera, të përcaktuara me ligj.

2. Të dhënat dhe treguesit e dokumentacionit të ri kadastral pasqyrohen në “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, të miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm.

3. DAMT-ja në Këshillin e Qarkut, për plotësimin e “Regjistrin të tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, i ofron ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki kopje të dokumentacionit, që ajo disponon, dhe kontrollon ecurinë e plotësimit të këtij regjistri nga ZMMT-ja.

4. Kopja e “Regjistrin të tokës bujqësore dhe disa kategorive të tjera të resurseve”, në formë manuale dhe e digjitalizuar, merret në dorëzim nga DAMT-ja, pas plotësimit të tij bazuar në udhëzimet përkatëse.

5. Për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën, DAMT-ja kërkon dhe i vihen në dispozicion nga institucionet e tjera shtetërore, veprimtaria e të cilave ka për objekt tokën bujqësore dhe disa kategori të tjera të resurseve, akte dhe informacione, si më poshtë vijon:

a) Nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) në rrethe:

i) Planimetritë kadastrale, planshetat e hartave kadastrale, librat e ngastrave që disponohen prej tyre, të cilat u janë dorëzuar në origjinal nga ish-zyrat e kadastrës së rretheve koordinatore të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose direkt ZVRPP-ve, në zbatim të urdhrit nr.511, datë 1.12.1995 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit “Për dorëzimin e akteve të pronësisë dhe përdorimit të tokës bujqësore koordinatore të rretheve të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Për nevoja pune ZVRPP-të mbajnë fotokopjet e tyre.

ii) ZVRPP-të t’i ofrojnë DAMT-ve të qarkut të gjitha kopjet e hartave treguese (HTR) dhe librave të ngastrave (LN) në formë elektronike dhe/ose manuale.

Shpenzimet e marrjes së këtij dokumentacioni mbulohen nga buxheti i këshillit të qarkut.

b) Nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-it, kopje të vendimeve, me hartat përkatëse (manuale dhe digjitale), që janë marrë për legalizimin e ndërtimeve informale, sipas komunave dhe/ose bashkive.

c) Nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, kopje të vendimeve (instrumenteve) bashkë me planimetritë përkatëse, që janë miratuar nga këto struktura për kalimin e tokave bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve në tokë urbane (truall), bazuar në dispozitat e ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, si dhe për periudhën vijuese sipas ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

ç) Nga autoritetet vendore të planifikimit të territorit pranë këshillave të qarqeve dhe pranë komunave dhe/ose bashkive, kopjen e instrumenteve të planifikimit të territorit dhe të hartave (planimetrive) të sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe të kategorive të tjera të resurseve, për të cilat janë marrë vendime për kalim të tyre në tokë urbane (truall).

d) Nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kopje të akteve që janë lëshuar prej saj, për kalimin e tokës bujqësore në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike;

dh) Nga drejtoritë e shërbimit pyjor (DSHP), kopje të akteve të miratuara nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe planimetritë përkatëse, që kanë si objekt kalimin e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe të fondit kullor në kategorinë e resursit tokë bujqësore.

6. DAMT-ja bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për këmbimin e informacioneve, të treguesve dhe të të dhënave, që krijohen nga zbatimi i programeve dhe projekteve me objekt tokën bujqësore dhe disa kategori të resurseve të tjera, të realizuara nëpërmjet GIS-it, matjeve të thjeshta të ndryshme, inventarizimeve, rlevimeve topografike, fotografimeve ajrore, pamjeve satelitore etj.

6.1. Këmbimi i ndërsjellë i informacioneve, treguesve dhe i të dhënave ndërmjet institucioneve shtetërore bëhet pa pagesë.

7. DAMT-ja, bazuar në dokumentacionin, aktet, treguesit dhe informacionet e përcaktuara sipas kreut II dhe kreut III, si dhe sipas informacioneve dhe të dhënave plotësuese, që disponohen dhe krijohen nga veprimtaria e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, në Fushë-Krujë, e institucioneve të tjera shtetërore, organizon punën për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën dhe integrimin gradual të tij në GIS, për të gjitha resurset që ka në administrim, brenda territorit të qarkut.

8. Sistemi i Informacionit për Tokën është unik dhe si njësi bazë në pasqyrimin e të dhënave dhe të treguesve ka ngastrën (parcelën) e tokës bujqësore në pronësi private apo në pronësi shtetërore (publike).

9. Drejtimi metodik dhe teknik i krijimit të Sistemit të Informacionit për Tokën realizohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit sipas programeve dhe detyrave që miratohen me urdhra apo udhëzime të ministrit.

IV. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË ZYRAVE TË MENAXHIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS (ZMMT) NË KOMUNA DHE/OSE BASHKI

1. Pranë çdo komune dhe/ose bashkie funksionon ZMMT-ja. Në detyrën e punonjësit të ZMMT-së mund të emërohen specialist, që kanë kryer arsimin e lartë, të profesioneve agronomë, inxhinier gjeodetë ose, në mungesë të tyre, topograf me përvojë në këtë profesion mbi 10 (dhjetë) vjet.

2. ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera, të përcaktuara në nenin 11 të ligjit 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, për të gjithë territorin në juridiksion të komunës dhe/ose bashkisë.

b) Mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj.

c) Përgjigjet për grumbullimin dhe sistemimin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe të kategorive të resurseve të tjera që me ligj janë transferuar në përdorim/pronësi të komunave dhe/ose bashkive, sipas burimeve të informacionit të përcaktuara në pikat 5, 6, dhe 7, të kreut III të këtij vendimi.

d) Bazuar në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe dokumentacionin e ri kadastral, që grumbullohet dhe sistemohet, plotëson “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, të miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm.

d.1 Kopja e plotësuar e “Regjistrin të tokës bujqësore dhe disa kategorive të tjera të resurseve” i dorëzohet në formë manuale dhe të digjitalizuar DAMT-së së qarkut.

dh) Ndjek veprimtarinë për evidentimin e tokave bujqësore të pakultivuara, në juridiksionin e komunës dhe/ose bashkisë, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë këtë veprimtari.

e) Ndjek zbatimin e procedurave për qiradhënien e tokave bujqësore të pandara (me origjinë nga ish-kooperativat bujqësore), në pronësi shtetërore apo që janë transferuar në përdorim/pronësi të komunës dhe/ose bashkisë, bazuar në dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

ë) Evidenton sipërfaqet e dhëna me qira dhe i dërgon informacione periodike DAMT-së në qark.

f) Evidenton në nivel ngastre (parcele), fshati (zone kadastrale) dhe komune/bashkie, ndryshimet dhe kalimet e ndërsjella të kategorive të resurseve, për të cilat janë marrë vendime nga organet shtetërore, që ligji i ka ngarkuar me kompetenca vendimmarrëse në këtë fushë.

f.1 Mbi bazën e këtij evidentimi, përgatit “evidencën e gjendjes dhe ndryshimit të kategorive të resurseve”, që i dërgohet DAMT-së në qark, brenda datës 15 janar të vitit pasardhës.

g) Përgatit të dhëna e informacione për përdorimin e resurseve të tokës, sipas kërkesave që bëhen nga komuna dhe/ose bashkia, DAMT-ja e qarkut dhe struktura të tjera të qeverisjes qendrore.

gj) Mbi bazën e dokumentacionit, që disponohet, i dërgon DAMT-së së qarkut të dhënat dhe informacione, në çdo rast, kur këto kërkohen.

h) Shqyrton kërkesat e subjekteve të interesuara për ndryshim të kategorive të resurseve të tokës dhe përgatit raportet teknike për këto kërkesa duke ia paraqitur për shqyrtim, sipas rastit, kryetarit apo këshillit të komunës dhe/ose bashkisë.

i) Vendimet e miratuara për ndryshim të kategorive të resurseve, si dhe kërkesat bashkë me dokumentacionin përkatës ia dërgon DAMT-së së qarkut;

ii) Për kërkesat e pamiratuara për ndryshimin e kategorive të resurseve, njofton me shkrim subjektet e interesuara.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DAMT-VE DHE ZMMT-VE PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË NDRYSHIMIT TË KATEGORIVE TË TOKËS BUJQËSORE SIPAS BONITETIT

ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki dhe DAMT-ja e qarkut, për shqyrtimin e kërkesave dhe të propozimeve për ndryshimin e kategorive të tokës bujqësore sipas bonitetit, zbatojnë kriteret dhe procedurat, si më poshtë vijon:

1. Kategoria e tokës bujqësore sipas bonitetit lejohet të ndryshohet vetëm kur mbi këtë sipërfaqe kanë vepruar faktorë natyrorë të fuqisë madhore, si: tërmetet, vullkanet, rrëshqitjet masive të sipërfaqeve të tokës, përmytjet, zjarre masive, fundosje të shtresave të tokës dhe faktorë të tjerë, të kësaj natyre.

2. Veprimi i faktorëve natyrorë të fuqisë madhore kërkohet të jetë i dokumentuar sipas njëres nga këto mënyra:

a) Me procesverbal, të mbajtur në kohën e dëmtimit, i konfirmuar (nënshkruar) nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRBUMK), inspektori i IMT-së në qark dhe përgjegjësi i ZMMT-së në komunë dhe në bashki. Në procesverbal pasqyrohen dhe përshkruhen dëmtimet e dukshme fizike të tokës të shkaktuara nga faktorët natyrorë të fuqisë madhore.

b) Me dokumentacionin e mbajtur nga IMT-ja, sipas procedurave të përcaktuara në pikat 5 deri 8 të kreut IV të vendimit nr.80, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

3. Pronari privat i tokës bujqësore, për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore, sipas bonitetit, mund të paraqesë kërkesë pranë komunës dhe/ose bashkisë ku kjo sipërfaqe ndodhet, ku shënohet identiteti i kërkuesit dhe bashkëlidhur së cilës duhet të paraqiten:

a) dokumenti i noterizuar për disponimin e kësaj toke në pronësi;

b) planimetria e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi i kategorisë së tokës, sipas bonitetit, me kufij qartësisht të përcaktuar;

c) vërtetim për gjendjen ekzistuese të kategorisë së tokës, sipas bonitetit, me të cilën figuron kjo sipërfaqe sipas studimit, të lëshuar nga DAMT-ja në Këshillin e Qarkut;

ç) dokumentacionin, sipas pikës 2 të këtij kreu, që vërteton veprimin e faktorëve natyrorë të fuqisë madhore.

4. Këshilli i komunës dhe/ose bashkisë e shqyrton kërkesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të saj.

4.1. ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki përgatit paraprakisht një raport teknik, që miratohet nga kryetari i komunës dhe/ose bashkisë, në të cilin jepet mendimi a propozimi për miratim ose jo i kërkesës.

4.2. Në rastin e miratimit të saj, kërkesa me të gjitha dokumentet përbërëse në formë propozimi, bashkë me vendimin e këshillit të komunës dhe/ose bashkisë, i dërgohet DAMT-së në këshillin e qarkut. Në rastin e mosmiratimit, vendimi i njoftohet, me shkrim, kërkuarit të saj.

5. Organet e qeverisjes vendore apo institucionet e tjera shtetërore, të cilët, bazuar në aktet ligjore ose nënligjore e disponojnë tokën bujqësore në administrim/përdorim, mund të ushtrojnë kërkesën në DAMT-në e qarkut për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore, sipas bonitetit, kur vërtetojnë me dokumentacion veprimin mbi të, të faktorëve natyrorë të fuqisë madhore sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij kreu. Kërkesa përmban dokumentacionin e përcaktuar në pikat 2 e 3 të këtij kreu.

6. DAMT-ja, për kërkesat e paraqitura sipas pikave 2, 3, 4 e 5 të këtij kreu, bën verifikim për saktësinë e përmbajtjes së tyre dhe, kur i gjen ato në përputhje me dokumentacionin kadastral, të plotësuar me të gjitha elementet përbërëse të përcaktuara të tyre, ia dërgon për shqyrtim dhe miratim MBUMK-së.

6.1. Kur DAMT-ja i vlerëson të parregullta në përmbajtje dhe në procedurë kërkesat e ardhura nga komunat dhe/ose bashkitë, i rikthen ato me vërejtjet përkatëse.

6.2. Në çdo rast, DAMT-ja e qarkut bën shqyrtimin e kërkesave brenda 30 (tridhjetë) ditëve, duke filluar nga data e regjistrimit të tyre në zyrën e protokollit të këshillit të qarkut.

7. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshim të kategorive të tokës, sipas bonitetit, nga struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në MBUMK, analizat e tokave që kryhen nga QTTB-ja, Fushë-Krujë, si dhe procedurat e tjera konkrete për ndryshim të kategorive të tokës bujqësore përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

8. Në tokat bujqësore, për të cilat nuk është kryer studimi i bonitetit ose për të cilat nuk ekzistojnë të dhëna e tregues të këtij studimi, për efekt të administrimit të tyre apo të ndryshimit të kategorive të resurseve, pronarët apo poseduesit e ligjshëm të tyre, si dhe institucionet shtetërore që i kanë këto toka në administrim/përdorim sipas akteve ligjore dhe nënligjore, detyrohen të kryejnë analizat e tyre pranë QTTB-së, Fushë-Krujë.

9. Kërkesat për kryerjen e studimit të bonitetit për sipërfaqet e tokave bujqësore, në të cilat nuk është kryer ky studim ose nuk ekzistojnë të dhëna e tregues të tij, bëhen, si më poshtë vijon:

a) Nga pronarët privatë, kërkesat paraqiten në komunë dhe ose/bashki, ku shënohet identiteti i pronarit, dhe bashkëlidhur të cilave duhet të paraqiten:

i) dokumentacioni që vërteton pronësinë e ligjshme mbi tokën;

ii) planimetria e tokës në kufij qartësisht të përcaktuar;

iii) vërtetimin e DAMT-së kur për ngastrën (parcelën), objekt kërkesë, nuk disponohen të dhëna për kategorinë e saj, sipas bonitetit;

iv) shkaqet (arsyetimi) përse kërkohet kryerja e studimit të bonitetit.

ZAMT-ja në komunë dhe/ose bashki, kërkesën me dokumentacionin përkatës, ia dërgon DAMT-së në qark.

b) Nga organet e qeverisjes vendore dhe institucione të tjera shtetërore që disponojnë tokë bujqësore në administrim/përdorim sipas akteve, ligjore ose nënligjore, kërkesat për kryerjen e studimit të bonitetit të tokës i paraqiten DAMT-së, sipas përmbajtjes së përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike.

DAMT-ja në qark, për të dyja rastet, verifikon kërkesat e paraqitura dhe kur këto i gjen të rregullta, ia dërgon Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas shqyrtimit të tërësishëm të kërkesës së ardhur nga DAMT-ja, kur këtë e gjen në përshtatje me procedurat e

përcaktuara, ia dërgon QTTB-së, Fushë-Krujë, e cila lidh marrëveshje me subjektet kërkuese të përcaktuara në pikat 3 e 5 të këtij kreu. Për lidhjen e marrëveshjes, MBUMK-ja njofton përkatësisht QTTB-në dhe subjektet kërkuese.

10.1. Në rast se kërkesa nuk rezulton në përshtatje me procedurat e përcaktuara, i rikthehet DAMT-së.

11. Subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorisë së tokës sipas bonitetit, si dhe subjektet e interesuara për kryerjen e studimit të bonitetit për tokat bujqësore, në të cilat ky studim nuk është kryer apo nuk ekzistojnë të dhëna për kategorinë e tokës bujqësore sipas bonitetit, kryejnë paraprakisht likuidimin e shpenzimeve me tarifat e përcaktuara për QTTB-në.

12. QTTB-ja, brenda një muaji nga data e lidhjes së aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, kryen analizat dhe, bazuar në të dhënat e tyre, harton raportin teknik, të cilin bashkë me aktvlerësimet përkatëse ia dërgon MBUMK-së.

13. Struktura përgjegjëse për administrimin e tokës në MBUMK shqyrton dokumentacionin e ardhur nga QTTB-ja dhe, kur këtë e gjen të plotë, ia paraqet për miratim ministrit.

14. DAMT-ja në qark, përmbajtjen e urdhrin të ministrit ua komunikon subjekteve që kanë bërë kërkesë, ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki dhe i pasqyron ato në librin e bonitetit të tokës.

VI. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DAMT-VE DHE ZMMT-VE PËR PASQYRIMIN NË DOKUMENTACIONIN KADASTRAL TË GJENDJES SË TOKAVE BUJQËSORE SIPAS ZËRAVE KADASTRALË

1. Toka bujqësore, si kategori e veçantë resursi, pasqyrohet në dokumentacionin kadastral, e grupuar sipas zërave kadastralë:

a) Arë janë sipërfaqe të tokës bujqësore të mbjella me bimë arash ose të destinuara për mbjelljen e tyre;

b) Pemëtore janë sipërfaqe toke bujqësore të mbjella me pemë frutore dhe agrume;

c) Vreshta janë sipërfaqe toke bujqësore të mbjella me hardhi;

ç) Ullishte janë sipërfaqe toke bujqësore të mbjella me ullinj.

2. DAMT-ja bën ndryshimin e zërave kadastralë të tokës bujqësore nga “tokë arë” në zërin kadastral “pemëtore”, “vresht” dhe “ullishte” ose anasjellas vetëm në bazë të akteve të verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte.

3. Akti i verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte përpilohet nga grupi i ekspertëve që krijohet nga drejtori i DRBUMK-së.

3.1. Krijimi i grupit të ekspertëve të verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte dhe përmbajtja e aktit të verifikimit bëhen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3.2. Në përbërje të grupit të ekspertëve merr pjesë edhe përgjegjësi i ZMMT-së së komunës dhe/ose bashkisë përkatëse.

4. Një kopje e aktit të verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte ose të pakësimit të këtyre zërave i dërgohet DAMT-së së qarkut.

DAMT-ja e qarkut, në bazë të akteve të verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte ose të pakësimit të këtyre zërave, bën pasqyrimin e këtij ndryshimi në dokumentacionin kadastral ekzistues.

4.1. Ndryshimet e zërave kadastralë të tokës bujqësore sipas pikave 2 e 3 të këtij kreu, rrahën si pjesë e evidencës vjetore të fondit të tokës.

VII. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DAMT-SË PËR PËRDITËSIMIN DHE PËRDORIMIN E DOKUMENTACIONIT KADASTRAL, SI DHE PËR ZBATIMIN E POLITIKAVE TË PËRDORIMIT TË TOKËS

1. DAMT-ja e qarkut, në dokumentacionin kadastral kryen veprimet e ndryshimeve apo të kalimeve për sipërfaqet e kategorive të resurseve që vijnë për efekt të vendimeve të organeve kompetente, sipas përcaktimeve të pikës 5 të kreut III të këtij vendimi, dhe të dokumentacionit zyrtar, të krijuar sipas vendimit nr.655, datë 28.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.

1.1. Aktet zyrtare, për efekt të të cilave bëhen veprimet e ndryshimeve apo kalimeve të kategorive të resurseve në dokumentacionin kadastral, ruhen në mënyrë të përhershme në arkivin e DAMT-së.

2. Veprimet e ndryshimeve apo kalimeve të kategorive të resurseve kanë si njësi bazë parcelën apo numrin e pronësisë dhe pasqyrohen në nivel fshati (zone kadastrale), si dhe të komunës dhe/ose bashkisë.

3. Për veprimet që kryhen në dokumentacionin kadastral, DAMT-ja njofton me shkrim dhe urdhëron ZMMT-në për pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral të komunës dhe/ose bashkisë.

3.1. ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki nuk mund të kryejë veprime për ndryshime/kalime të kategorive të resurseve në dokumentacionin kadastral, pa urdhër me shkrim të DAMT-së.

4. DAMT-ja pasqyron ndryshimet dhe kalimet e kategorive të resurseve në evidencën përmbledhëse të fondit të tokës, në nivel komune dhe/ose bashkie, të qarkut dhe ia raporton MBUMK-së, në fund të çdo viti.

5. DAMT-ja organizon grupe ekspertësh, të veçantë ose në bashkëveprim me institucione të specializuara apo të licencuara, për kryerjen e matjeve të thjeshta apo rievimeve topografike për sipërfaqe të tokave bujqësore apo të kategorive të resurseve të tjera, për të cilat në dokumentacionin kadastral nuk ekzistojnë të dhëna për madhësinë e sipërfaqes së tyre.

5.1. Në çdo rast matjet e thjeshta dhe rievimet topografike ndërmerren vetëm pas ushtrimit të kërkesave me shkrim nga njësi të qeverisjes vendore, të këshillit të qarkut, si dhe të MBUMK-së.

5.2. Në përfundim të matjeve të thjeshta apo rievimeve topografike, grupi i ekspertëve krijon dokumentacionin përkatës, të përbërë nga harta, planimetri dhe regjistra, që ruhen në mënyrë të përhershme në arkivin e DAMT-së.

6. DAMT-ja pasqyron në librin (regjistrin) e studimit të bonitetit të tokave bujqësore çdo ndryshim të kategorive të tyre, të miratuara me urdhrin përkatës të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. DAMT-ja ndjek zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi, që kanë si objekt politikatat e përdorimit të tokës bujqësore në drejtim:

a) Të përdorimit dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në pronësi private, nëpërmjet bashkëveprimit me njësitë e qeverisjes vendore për evidentimin e sipërfaqeve të pakultivuara dhe vënien e tyre në përdorim dhe shfrytëzim për të tretë, duke zbatuar procedurat ligjore të qiradhënies së tyre. Në mënyrë periodike, grumbullon të dhëna nga ZMMT-të për sipërfaqet e tokave të pakultivuara dhe sipërfaqet e dhëna me qira. Pas përpunimit dhe sistemimit të tyre, informon për gjendjen këshillin e qarkut dhe MBUMK-në.

b) Siguron pjesëmarrjen e saj në bordet e qiradhënies së tokave bujqësore të pandara (me origjinë nga ish-kooperativa bujqësore), në pronësi shtetërore, që organizohen nga komunat dhe/ose bashkitë, si dhe në bordet e qiradhënies së tokave bujqësore disponibël shtetërore (me origjinë nga ish-NB-të), që organizohen nga DRBUMK-të.

Në mënyrë periodike grumbullon të dhëna nga ZMMT-ja dhe DRBUMK-ja për sipërfaqet e dhëna me qira të sipërfaqeve të tokave të pandara dhe të tokave disponibël shtetërore. Pas përpunimit dhe sistemimit të tyre, informon për gjendjen këshillin e qarkut dhe MBUMK-në;

c) Në bashkëveprim me organet e qeverisjes vendore dhe ZMMT-të, kontrollon dhe merr masa të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, në çdo rast kur vëren së në fondin e tokave bujqësore, në pronësi shtetërore, bëhen ndërhyrje në përdorim apo shfrytëzim të tyre në mënyrë të kundërligjshme nga persona të tretë.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen kryetarët e komunave dhe/ose bashkive që të kryejnë emërimet e punonjësve të ZMMT-ve sipas profesioneve të përcaktuara në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Për kontrollin e zbatimit të detyrimeve nga institucionet vartëse, të përcaktuara në pikën 5 të kreut III të këtij vendimi, ngarkohen:

- 2.1 Ministria e Drejtësisë, për institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”;
- 2.2 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për institucionet vartëse, për dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”;
- 2.3 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për institucionet e përcaktuara në shkronjën “dh”.
3. Në tabelën “Numri i punonjësve të seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, që i bashkëlidhet vendimit nr.64, datë 21.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillat e qarqeve, dhe të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”, të ndryshuar, pjesa e saj për numrin e punonjësve sipas nënndarjeve administrative, shfuqizohet.
4. Vendimi nr.532, datë 31.10.2002 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kryetarët e komunave dhe/ose bashkive në juridiksionin e tyre dhe kryetarët e këshillave të qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.122, datë 17.2.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1124, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE
KRITEREVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E SPECIALISTIT, PËR VLERËSIMIN
E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE AUDITIMIN MJEDISOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 31 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Të drejtën për t’u pajisur me certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike. Certifikata e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor jepet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.137, datë 1.3.2011

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS GOSË, Z. SINAN SHALA

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda ligjore, të kryetarit të komunës Gosë, z.Sinan Shala.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.138, datë 1.3.2011

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS DAJT, Z. KUJTIM QEFALIA

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda ligjore, të kryetarit të komunës Dajt, z.Kujtim Qefalia.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.187, datë 9.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1078, DATË 29.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR AUTORIZIMIN E IMPORTIT TË MBETJEVE METALIKE TË HEKURIT DHE ÇELIKUT, PËR QËLLIME RICIKLIMI, NGA SHOQËRIA KURUM INTERNATIONAL SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të nenit 26 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1078, datë 29.12.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Mbetjet importohen nga shtete të Bashkimit Europian apo shtete anëtare të Konventës së Bazelit, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe në bazë të kërkesave të përcaktuara në pikën II të vendimit nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, shoqëria Kurum International sh.a., dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit nr.825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.

5. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analize, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

6. Skrapi i importuar nuk duhet të ketë në përbërje të tij mbetje apo pjesë predhash e municionesh luftarake.”.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM Nr.6 datë 17.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 6257, DATË 2.9.2008 “MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, të ndryshuar dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”,

UDHËZIJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas germës “a” të pikës 7/1, shtohet germa a/a me këtë përmbajtje:

“a/a. Asnjë anëtar i familjes që përfiton kredi të lehtësuara, të mos jetë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar”.

2. Pas pikës 7/6, shtohet pika 7/7 me këtë përmbajtje:

“7/7 Banka nuk lidh kontratë, nëse qytetari përfitues i kredisë me interes 0%, nuk dorëzon një deklaratë noteriale që ai dhe familja e tij pranojnë të lirojnë banesën e pronarit brenda 30 ditëve nga data e livrimit të kredisë, përveç rasteve kur ka marrëveshje noteriale me pronarin/pronarët.

3. Pika 19 ndryshon si më poshtë:

“Enti Kombëtar i Banesave ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e programit, bazuar në kontratat e lidhura mes bankës dhe familjeve, si dhe bën verifikimet e nevojshme në të gjitha institucionet publike e private, qendrore e vendore, të ngarkuara për lëshimin e dokumenteve sipas këtij udhëzimi. Për këtë, një kopje e kontratës së kreditimit dhe e dokumentacionit që shoqëron çdo kontratë, i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave nga banka. Për këtë shërbim, EKB-ja përfiton 1% të fondit të subvencionit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve operative. Kjo shumë mbahet mbi çdo disbursim të subvencionit që EKB-ja i bën bankës, sipas pikës 18.”.

4. Pas pikës 19, shtohen pikat 19/1 dhe 19/2 me këtë përmbajtje:

“19/1. EKB-ja njofton bankën për ndërprerjen e subvencionit, kur nga verifikimet që kryen EKB-ja në mënyrë rastësore ose specifike, bazuar në ankesa apo denoncime të individëve a institucioneve, konstatohen:

a) se qytetari nuk ka liruar banesën e pronarit brenda afatit të përcaktuar në pikën 7/6 të këtij udhëzimi;

b) falsifikime të dokumenteve apo deklarata të rreme;

c) mospërmbushje e të gjitha kushteve të parashikuara në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008, të ndryshuar, nga ana e bankës së përzgjedhur për dhënien e kredisë.

19/2 Çështjet “a” dhe “b” të pikës 19/1, të jenë pjesë e kontratës që lidh banka me subjektet përfituese, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.”.

5. Pas pikës 21, shtohen pikat 21/1, 21/2, 21/3 e 21/4, me këtë përmbajtje:

“21/1. Të gjitha institucionet shtetërore, të cilat kanë miratuar listën e përfituesve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, dorëzojnë pranë EKB-së listën emërore të përfituesve dhe kopjen e plotë të dokumentacionit të dorëzuar nga nëpunësi pranë institucionit përkatës konform vendimit të sipërcituar. Në mungesë të këtij dokumentacioni, EKB-ja nuk procedon me rimbursimin e subvencionit për këto subjekte.

21/2. Kontrata nuk lidhet edhe në rastet kur konstatohet se subjektet përfituese nga njëri prej nënprogrameve të kreditimit të lehtësuar, kanë përfituar nga programe shtetërore të mëparshme strehimi.

21/3. Banka akordon kredinë për subjektin që ka përfituar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 vetëm për blerje banese në qytetin ku subjekti ushtron veprimtarinë për të cilën ka përfituar të drejtën e subvencionimit.

21/4. Nëse subjekti përfitues figuron në disa lista, ai mund të përfitojë vetëm nga njëri prej 3 nënprogrameve të kreditimit të lehtësuar, sipas përzgjedhjes së tij/saj.”.

6. Pas pikës 22, shtohen pikat 23, 24, 25 e 26, respektivisht me këtë përmbajtje:

“23. Kontrata e kreditimit lidhet mes bankës dhe të gjithë pjesëtarëve madhorë të familjes.

24. Për lidhjen e kontratës me bankën, familjet, emrat e të cilëve janë miratuar me vendim të këshillave bashkiakë dhe i janë dërguar bankës, kanë një afat prej 6 (gjashtë) muaj nga data e njoftimit zyrtar që bashkia i bën të interesuarit. Skadencia e këtij afati fillon me datën e protokollimit të korrespondencës së dërguar nga bashkia EKB-së. Në rast se pas kalimit të këtij afati, familja ende nuk ka gjetur banesë, paraqitet pranë EKB-së për të kërkuar shtyrje të afatit.

25. Në rast se familja nuk paraqitet brenda 6 muajve, veprohet sipas rasteve më poshtë:

a) Kur nga bashkitë janë dërguar lista rezervë, banka në rakordim me EKB-në vijon me listën emërore rezervë.

b) Kur lista rezervë është shteruar, EKB-ja njofton bashkinë përkatëse për dërgimin e emrit/emrave të tjerë sipas kuotës që përfiton bashkia.

26. Kur familja paraqitet brenda 6 muajve pranë EKB-së, duke kërkuar shtyrje të afatit, emri i subjektit vazhdon të qëndrojë në listë pritjeje edhe për 6 muaj të tjerë. Më pas, EKB-ja njofton bashkinë sipas rasteve më sipër.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.14, datë 28.2.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP OSTROVICA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Faqekuq 1” me fuqi 3 MW dhe “Faqekuq 2” me fuqi 3.4 MW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.15, datë 28.2.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HP OSTROVICA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “g”, nenit 8, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.16, datë 28.2.2011

**PËR MBYLLJEN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR SHOQËRINË “BALKAN
FINANCE INVESTMENT GROUP” SHPK, LIDHUR ME KËRKESËN PËR MARRJEN E
STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 99 dhe 101, pika 1, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga subjekti “Balkan Finance Investment Group” sh.p.k., për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe më pas kërkesën për tërheqje nga aplikimi për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të mbyllë procedimin administrativ për shoqërinë “Balkan Finance Investment Group” sh.p.k., lidhur me kërkesën për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.35, datë 1.2.2011

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.33, DATË 15.2.2010 “PËR SKEMËN EKZISTUESE
TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------|---------|
| - Nasip Naço | kryetar |
| - Mimoza Dhëmbi | anëtare |
| - Besjan Pasha | anëtar |
| - Arben Ndoci | anëtar |
| - Zef Preçi | anëtar, |

në mbledhjen e tij të datës 1.2.2011, shqyrtoi vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.33, datë 15.2.2010 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave” dhe argumentet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit për Transportin në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit me shkresë nr.4828/1, datë 21.12.2010, lidhur me përgatitjen e planit të ristrukturimit të sektorit hekurudhor,

VËREN SE:

Subvencionimi nga Buxheti i Shtetit i “Hekurudha Shqiptare” sh.a., lidhur me shërbimin e transportit të udhëtarëve, në bazë të nenit 4 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmë shtetërore”, të ndryshuar, nuk përbën ndihmë shtetërore për arsye se ndërmarrja (“Hekurudha Shqiptare” sh.a.), është operator i vetëm në treg dhe operon vetëm brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë, si rrjedhim nuk ndikon ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën dhe nuk ka asnjë efekt në tregun e brendshëm të transportit hekurudhor dhe atë ndërmjet shteteve.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), me shkresë nr.4828/1, datë 21.12.2010, paraqiti të gjitha argumentet e grupit të punës për hartimin e planit të ristrukturimit dhe konsulentëve të huaj, lidhur me gjendjen dhe problematikën e sektorit hekurudhor. Sipas MPPT-së me nivelin aktual të investimeve për “Hekurudha Shqiptare” sh.a., nuk mund të ketë përmirësim të gjendjes së infrastrukturës dhe të superstrukturës hekurudhore dhe për këtë arsye nuk do të mund “të përgatitet një plan ristrukturimi, ku të përcaktohen masat që do t’i kthejnë rentabilitetin këtij sektori, së bashku me afatet përkatëse”, siç parashikohet në vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.33, datë 15.2.2010.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenet 4 pika 1, 17 shkronja “ç” dhe nenit 19 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në nenet 121 dhe 124 të ligjit nr.8485, datë 27.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Revokimin e vendimit nr.33, datë 15.2.2010 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço

VENDIM

Nr.36, datë 1.2.2011

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRYERJEN NGA “POSTA SHQIPTARE” SHA TË SHËRBIMEVE POSTARE, FINANCIARE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA, QË JANË NË PËRPUTHJE ME AKTIVITETIN E “POSTA SHQIPTARE” SHA PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE E VENDORE, INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE, SI DHE SHOQËRITË TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Nasip Naço kryetar
- Mimoza Dhëmbi anëtare
- Besjan Pesha anëtar
- Arben Ndoci anëtar
- Zef Preçi anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 1.2.2011, shqyrtoi njoftimin e planit “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” sh.a., për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit me shkresën nr.4552, datë 1.12.2010 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/N/9/2011 datë 12.1.2011.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës:

VËREN SE:

1. Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv kryesor ofrimin e disa shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik nga “Posta Shqiptare” sh.a., për llogari të institucioneve të sektorit publik në nivel qendror dhe vendor, si edhe ndërmarrjeve me kapital shtetëror.

2. Plani për dhënien e ndihmës synon të lejojë shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., të jetë ofruesi i vetëm për shërbimet postare dhe financiare, si dhe të jetë ofruesi i parë i shërbimeve të tjera që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” sh.a., për llogari të institucioneve të sektorit publik në nivel qendror dhe vendor, si edhe ndërmarrjeve me kapital shtetëror.

3. Si bazë për dhënien e kësaj ndihme është projektvendimi “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” sh.a., për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”.

4. Dhënësi i ndihmës është Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

5. Plani i ndihmës mbulon sektorin postar dhe përfitues i ndihmës individuale shtetërore është shoqëria me kapital 100% shtetëror “Posta Shqiptare” sh.a.

6. Kohëzgjatja e ndihmës parashikohet të jetë periudha 2011-2016.

7. Masa e ndihmës konsiderohet si ndihmë shtetërore për kompensimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik. Në bazë të udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, miratuar me vendimin e KNSH-së nr.26, datë 17.6.2008, klasifikohet shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik, çdo veprimtari ekonomike e konsideruar nga organet shtetërore me interes të veçantë publik dhe që nuk mund të sigurohet pa ndërhyrjen e shtetit. Shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik janë ato shërbime që kanë rëndësi të caktuar ekonomike, sociale dhe rajonale për publikun.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 17 shkronja “ç” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, miratuar me vendimin e KNSH-së nr.26, datë 17.6.2008,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me aktivitetin e “Posta Shqiptare” sh.a., për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”.

2. Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit të lidhë kontratën e shërbimit publik me “Posta Shqiptare” sh.a., në të cilën të përcaktohet qartë detyrimi për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik.

3. “Posta Shqiptare” sh.a. duhet të ketë llogari të ndara për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik.

4. Të ardhurat e fituara nga “Posta Shqiptare” nga këto shërbime nuk duhet të sjellin mbikompensim.

5. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë koston e nevojshme për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, duke marrë parasysh të ardhurat vjetore dhe një përfitim të arsyeshëm.

6. Kompensimi duhet të përdoret vetëm për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik. Në rast se kompensimi i dhënë përdoret për ushtrimin e veprimtarive të tjera nga ana e “Posta Shqiptare” sh.a., ai do të konsiderohet ndihmë shtetërore e paligjshme.

7. Të njoftohet pranë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës çdo ndryshim i mundshëm i planit të ndihmës sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore në fuqi.

8. Në bazë të nenit 18 shkronjat “a” dhe “c” ngarkohet Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore të monitorojë zbatimin dhe rezultatin ekonomik nga përdorimi i kësaj ndihme.

9. Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë:

- raportin për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar;
- të deklarojë çdo vit planifikimin e tarifave për vitin pasardhës dhe nivelin e tyre për çdo shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik; si dhe
- të japë çdo informacion që do të kërkohet, si dhe për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço

VENDIM
Nr.37, datë 1.2.2011

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR NDIHMËN SHTETËRORE NË SEKTORIN POSTAR”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “d” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndhmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në sektorin postar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço

UDHËZIM
PËR NDIHMËN SHTETËRORE NË SEKTORIN POSTAR

1. Hyrje
Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve, mbi bazën e të cilave mund të lejohet ndihma shtetërore në sektorin postar.
2. Përkufizime
Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 1. “Shërbime postare” janë shërbimet e pranimit, klasifikimit, transportit dhe dorëzimit të objekteve postare.
 2. “Rrjet postar publik” është sistemi i organizimit dhe i burimeve të ndryshme të përdorura nga ofruesi i shërbimit universal për qëllime të pranimit, përpunimit, vijimit dhe dorëzimit të objekteve postare.
 3. “Pikat e hyrjes” janë objektet fizike, duke përfshirë kutitë e letrave në dispozicion të publikut, të vendosura në ambiente publike ose në ambientet e ofruesit të shërbimit universal, ku klientët mund të depozitojnë objektet postare në rrjetin publik postar.
 4. “Pranimi” është veprimtaria e mbledhjes së objekteve postare të depozituara në pikat e hyrjes.

5. “Shpërndarja” është procesi që nis me klasifikimin e objekteve postare në qendrën e shpërndarjes dhe përfundon me dërgimin e objekteve postare në adresat e tyre.

6. “Objekt postar” është çdo lloj objekti i transmetuar nga operatori postar (objekte të postës së letrave, koliposta, urdhërpagesa postare etj.).

7. “Objekte të korrespondencës” janë komunikime në formë të shkruar, me çdo lloj mjete fizik dhe të dorëzuar në adresën e treguar nga dërguesi. Librat, katalogët, gazetat dhe revistat nuk do të konsiderohen si objekte të korrespondencës.

8. “Posta direkte” është një komunikim që ka të bëjë vetëm me material reklame ose marketingu dhe që përmban një mesazh identik, me përjashtim të emrit, adresës apo të të dhënave të tjera, të cilat nuk e ndryshojnë natyrën e mesazhit dhe që i dërgohet një numri të ndjeshëm personash. Faturat, dëftesa pagesash dhe mesazhe të tjera joidentike nuk do të konsiderohen si postë direkte.

9. “Shërbimi i postës ekspres” është një shërbim i veçantë, që ofron shpejtësi më të madhe dhe garanton shpërndarjen në një datë të caktuar; mbledhjen nga pika e origjinës; dorëzimin personal në adresën e dhënë, mundësinë e ndryshimit të destinacionit dhe adresën në tranzit; konfirmim të dërguesit për pranimin e sendit të dërguar, monitorimin dhe ndjekjen e sendeve të dërguara, shërbim të personalizuar për klientët dhe ofrimin e çmimeve të veçanta për çdo shërbim, si dhe kur kërkohet. Konsumatorët në parim janë të përgatitur të paguajnë një çmim më të lartë për këtë shërbim.

10. “Ofruesi i shërbimit universal” është çdo person juridik apo fizik, i cili ofron një shërbim universal postar ose pjesë të tij.

11. “Subvencionimi i kryqëzuar” nënkupton që një ndërmarrje, një pjesë ose të gjitha kostot e aktivitetit të saj në një treg gjeografik, ose produkti i mbart ose i shpërndan te një tjetër treg gjeografik apo produkti.

12. “Ndërmarrje publike” është çdo ndërmarrje mbi të cilën autoritetet publike mund të ushtrojnë, direkt ose indirekt, një ndikim mbizotërues në bazë të së drejtës së pronësisë ose pjesëmarrjes financiare në të.

13. “Të drejta ekskluzive” janë të drejtat e dhëna nga një organ shtetëror kompetent nëpërmjet dispozitave ligjore apo nënligjore, efekti i të cilave është të kufizojë ofrimin e shërbimeve postare, për një apo më shumë ente, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në aftësinë e enteve të tjera për të kryer atë veprimtari, brenda një hapësire të caktuar gjeografike.

14. “Të drejta të veçanta” janë të drejtat e dhëna për një numër të kufizuar ndërmarrjesh nëpërmjet dispozitave ligjore apo nënligjore, brenda një zone të caktuar gjeografike:

a) Kufizon dy ose më shumë ndërmarrje të autorizuara për të ofruar një shërbim apo ushtrojnë një aktivitet, në bazë të kriterëve objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese; ose

b) Cakton, në bazë të kriterëve të tilla, disa ndërmarrje konkurruese si ndërmarrje të autorizuara për të ofruar një shërbim apo kryer një veprimtari; apo

c) I jep një apo më shumë ndërmarrjeve, në bazë të kriterëve të tilla, përparësi ligjore ose rregullatore të konsiderueshme, të cilat ndikojnë në aftësinë e çdo ndërmarrjeje tjetër për të ofruar të njëjtin shërbim, ose të ushtrojnë të njëjtën veprimtari në të njëjtën zonë gjeografike nën kushte thelbësisht të krahasueshme.

15. “Ndërmjetës” është çdo operator ekonomik, i cili vepron me dërguesit dhe ofruesit e shërbimit universal, duke hapur dhe/ose klasifikuar dërgesat postare, para se ato të kanalizohen në rrjetin publik postar të vendit ose të një vendi tjetër.

16. “Autoriteti kombëtar rregullator” është organi, të cilit i janë besuar, ndër të tjera, funksionet rregullatore që janë brenda fushëveprimit të legjislacionit postar.

17. “Kërkesë thelbësore” është çdo shkak i përgjithshme joekonomik, i cili mund të shkaktojë imponimin e kushteve për furnizimin e shërbimeve postare. Këto arsye janë: fshehtësia e korrespondencës; siguria e rrjetit për sa i përket transportit të mallrave të rrezikshme; dhe, kur është e justifikuar, mbrojtja e të dhënave, mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi rajonal.

3. SUBVENCIONIMI I KRYQËZUAR

1. Subvencionimi i kryqëzuar lejohet kur kostot për aktivitetet e rezervuara janë të

subvencionuara nga të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e tjera të rezervuara, ose nga aktivitete të hapura për konkurrencë.

2. Subvencionimi i aktiviteteve të hapura për konkurrencë, duke i shpërndarë kostot e tyre për shërbimet e rezervuara është e ndaluar.

3. Subvencionimi i kryqëzuar mund të konsiderohet i ligjshëm, në rastin e postës kulturore, kur zbatohet në mënyrë jodiskriminuese, ose për shërbime me rëndësi të veçantë për shoqërinë, mjekësinë dhe rajone ekonomisht të pafavorizuara.

4. Komisioni vendos, rast pas rasti, çdo përjashtim tjetër që mund të lejohet në përputhje me ligjin.

4. NDËRMARRJET PUBLIKE DHE TË DREJTA TË VEÇANTA OSE EKSKLUZIVE

1. Të drejta të veçanta apo ekskluzive mund t'u jepen ndërmarrjeve publike ose private.

2. Mbajtja e të drejtave të veçanta ose ekskluzive, e cila kufizon dhënien e shërbimeve postare ndërkufitare duhet të justifikohet për shkak të ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik. Të drejtat e veçanta ose ekskluzive, fusha e zbatimit të të cilave nuk shkon përtej shërbimeve të rezervuara, janë të lejuara.

3. Në rastin e ndërmarrjeve publike, të cilat gëzojnë të drejta të veçanta ose ekskluzive, nuk duhet të zbatohen asnjë masë që është në kundërshtim me ligjet në fuqi apo me rregullat e ndihmës shtetërore në veçanti.

5. OPERATORËT POSTARË DHE NDIHMA SHTETËRORE

1. Në bazë të nenit 20 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, dhënësit e ndihmës duhet të njoftojnë pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore për miratim të gjitha planet për dhënien e ndihmës shtetërore ose për ndryshimin e ndihmave ekzistuese.

2. Komisioni është i detyruar të mbikëqyrë përdorimin e ndihmës së miratuar.

3. Ofruesit e shërbimit universal duhet të zbatojnë detyrimin mbi transparencën e marrëdhënieve financiare midis shtetit dhe ndërmarrjeve publike.

4. Ndërmarrjet e përmendura në pikën 4, duhet që përveç kërkesave të përgjithshme të transparencës mbi pasqyrat financiare, të sigurojnë që marrëdhëniet financiare mes shtetit dhe tyre të jenë transparente, duke pasqyruar qartë elementet e mëposhtme:

a) fonde publike që janë vënë në dispozicion në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përfshirë përjashtimet apo reduktime nga taksat;

b) fonde publike që janë dhënë nga ndërmarrjet e tjera ose institucionet financiare publike;

c) arsyet e përdorimit të fondeve publike.

6. SHËRBIMI ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK

Rregullat e përgjithshme që duhet të zbatohen në sektorin postar lidhur me të drejta ekskluzive dhe të veçanta të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik janë:

a) Liberalizimi i shërbimeve të tjera postare

Përveç atyre shërbimeve për të cilat është i nevojshëm rezervimi, të gjitha të drejtat e veçanta apo ekskluzive nuk zbatohen për ofrimin e shërbimeve postare, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe me ligj ose akte nënligjore. Të gjithë operatorëve ekonomikë u garantohet e drejta për ofrimin e shërbimeve postare.

b) Eliminimi i mjeteve kufizuese për të siguruar ofrimin e shërbimeve në interes të përgjithshëm ekonomik

Të drejtat ekskluzive mund të jepen ose të mbahen vetëm kur ato janë të domosdoshme për të siguruar funksionimin e detyrave me interes të përgjithshëm ekonomik. Në qoftë se operatori i përmendur në pikën 4 nuk arrin të sigurojë në mënyrë të kënaqshme të gjitha elementet e shërbimit, atëherë të drejtat e veçanta ose ekskluzive i hiqen, në këtë rast, u krijohet mundësia konkurrentëve që të ofrojnë shërbimet.

c) Proporcionaliteti

Dhënia e të drejtave të veçanta dhe ekskluzive duhet të jetë në përpjesëtim me interesin e përgjithshëm ekonomik, i cili synohet të arrihet me anë të këtyre të drejtave. Dhënia e të drejtave të veçanta ose ekskluzive mund të ndryshohet në përputhje me ndryshimin e nevojave dhe kushteve,

sipas të cilave jepen shërbimet postare dhe duke marrë parasysh çdo ndihmë shtetërore të përfituar nga operatori.

ç) Monitorimi nga një organ i pavarur rregullator

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare monitoron përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik nga operatorët, aksesin e hapur në rrjetin publik postar dhe, kur është e zbatueshme, jep licenca apo kontroll-deklarimet, si dhe zbatimin e të drejtave të veçanta ose ekskluzive nga operatorët ekonomikë.

2. Ky organ duhet të sigurojë në mënyrë të veçantë:

a) që kontratat për sigurimin e shërbimeve të rezervuara të bëhen plotësisht transparente;

b) të jenë faturuar veçmas dhe të dallohen nga shërbimet jo të rezervuara;

c) se afatet dhe kushtet për shërbimet që janë në pjesën e rezervuar dhe pjesërisht të liberalizuara janë të ndara; dhe

ç) se elementi i rezervuar është i hapur për të gjithë përdoruesit postarë, pavarësisht nëse elementi jo i rezervuar është blerë apo jo.

d) Monitorimi efektiv i shërbimeve të rezervuara

Ofrimi i shërbimeve të rezervuara, arritja e objektivave për të cilin ato janë dhënë dhe nivelet e performancës duhet të raportohen rregullisht dhe publikisht.

e) Transparenca

Ndërmarrjet e përmendura në pikën 4 duhet të mbajnë llogari të veçanta financiare për çdo shërbim të ofruar, duke përcaktuar veçmas, kostot dhe të ardhurat që lidhen me ofrimin e shërbimeve të ofruara mbi bazën e të drejtave ekskluzive dhe atyre të ofruara në kushte konkurruese. Llogaritë financiare duhet të hartohen, të auditohen nga një auditues i pavarur, dhe të publikohen në përputhje me legjislacionin përkatës.

f) Hyrje jodiskriminuese në rrjetin postar

Operatorët duhet të ofrojnë shërbimin universal postar, duke krijuar mundësinë e aksesit për çdo shtetas me tarifa dhe çmime ekonomike për këdo.

KËRKESË

Shtetasi Bujar Sula, i biri i Hakiut, i datëlindjes 8.9.1940, lindur në Aranitas, Fier dhe banues në Tepelenë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Haki Sula.

KËRKUESI
Bujar Sula

KËRKESË

Shtetasja Enada Ismailaj, e bija e Paqësorit dhe e Verës, e datëlindjes 2.5.1989, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të babait të saj, shtetasit Paqësor Ismailaj.

KËRKUESJA
Enada Ismailaj

KËRKESË

Shtetasja Valentina Bineri, e bija e Dhiogjenit, e datëlindjes 20.9.1971, lindur në Delvinë dhe banuese në Vane, Delvinë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë shpalljen të vdekur të shtetasit Evangjellos Bineri.

KËRKUESJA
Valentina Bineri

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 21.3.2011
Doli nga shtypi më 23.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë